



Funded by
the European Union

unicef 
for every child

MODUL TRAJNUES

**MASAT E DIVERSITETIT QË SHQIPTOHEN
NDAJ KRYESIT TË MITUR TË VEPRËS PENALE**



Terre des hommes
Ndihmë për fëmijët.

Prishtinë
Dhjetor 2023

Autor i Modulit:

Ardian Klaiqi, Avokat dhe specialist i drejtësisë për të mitur

Ky Modul është përgatitur në kuadër të projektit Mbrojtja e Fëmijëve të cenushëm në Kosovë, financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë dhe zbatuar nga UNICEF. Moduli është pjesë e komponentit të projektit të përbashkët mes UNICEF dhe Terre des hommes "Rritja e qasjes dhe cilësisë së kujdesit dhe shërbimeve sociale dhe arsimore për vajzat dhe djemtë e cenueshëm, veçanërisht ata në situatë rruge dhe familjet e tyre".

Materialet, përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë Modul janë ato të ekspertit të angazhuar dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNICEF-it ose të BE-së. Botimi nuk është redaktuar sipas standardeve zyrtare të publikimit të UNICEF-it dhe BE-së, të cilët nuk marrin përgjegjësi për ndonjë gabim drejtshkrimor.

1. HYRJE	4
2. SHKURTESA	6
3. OBJEKTIVAT E MODULIT DHE REZULTATET E PRITURA	8
Objektivat e modulit	8
Rezultat e pritura	8
4. MASAT E DIVERSITETIT SI SHMANGIE NGA SISTEMI	9
5. INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE	10
6. PARIMET UDHËHEQËSE	14
7. QËLLIMI I MASAVE	15
8. KUSHTET PËR SHQIPTIMIN E MASAVE	16
9. PROCEDURA PËR SHQIPTIMIN E MASËS	17
10. SHQIPTIMI DHE EKZEKUTIMI I TYRE	20
11. LLOJET E MASAVE TË DIVERSITETIT (RISITË)	25
12. PËRZGEDHJA DHE ZBATIMI	26
13. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL	38
14. PËRPARËSITË DHE DOBITË	40
15. ANEKSE	42
A)Terme dhe përkufizime nga KDM	42
B)Rast studimor	44
C)Forma të vendimeve	46
D)Burimet dhe materialet e konsultuara	55

1. HYRJE

Burgimi ndaj të miturve, gjithnjë gjatë historisë është shikuar dhe vlerësuar si i dëmshëm për zhvillimin psikik dhe fizik ndaj të miturve. Andaj, edhe një kohë të gjatë është diskutuar për të gjetur forma alternative në vend të burgimit në mënyrë që të arrihet efekti i njëjtë i risocializimit dhe riintegritit të qëndrueshëm në shoqëri. Këto diskutime më pastaj janë pasuar me një numër të madh të studimeve që janë realizuar me qëllim, jetësimin e formave alternative kundruall burgimit dhe sanksioneve tjera të tipit institucional.

Të gjeturat dhe konkluzionet nga këto studime si dhe krahasimi me aspektin praktik kanë rezultuar në transformimin e tyre në dispozita ligjore duke nxjerrë një mori aktesh me karakter ndërkombëtar dhe regjional. Kjo ka kulmuar me aprovimin nga ana Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF) dhe shumë instrumente tjera më shtrirje ndërkombëtare apo edhe regjionale.

Duke u bazuar në parimet dhe dispozitat kryesore të KDF, edhe në Kosovë janë bërë reforma të thella dhe të mëdha duke reflektuar ndryshimet e kërkuara, për të kaluar nga sistemi tradicional i bazuar në 'konceptin e drejtësisë ndëshkuese' tek 'koncepti i drejtësisë restauruese' nëpërmjet inkorporimit të masave dhe dënimeve alternative kundruall burgimit për të miturit.

Në këtë aspekt, pjesë shumë e rëndësishme e kësaj reforme kanë qenë edhe nxjerrja dhe aprovimi fillimisht i Ligjit për të Mitur në vitin 2004 dhe më pastaj edhe Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM) në vitin 2010, dhe së fundmi edhe të Kodit të Drejtësisë për të Mitur (tani e tutje KDM) në vitin 2018 (Kodi Nr.06/L-006).

Të tri këto kode edhe pse me ndryshime jo të mëdha, në mënyrë shumë përmbajtësore kanë inkorporuar parimin e zgjidhjes së rasteve përmes alternativave ndaj burgimit. Të gjitha masat e diversitetit dhe ato alternative me bazë edukative ishin bazuar në standardet tashmë të njohura në fushën e drejtësisë për të mitur.

Gjithsesi trendet e fundit në nivel global kanë sjellë shumë risi edhe në eksplorimin e formave të reja të masave të diversitetit dhe atyre edukative. Duke marrë parasysh suksesin e zbatimit dhe dhënies përparësi masave alternative ndaj burgimit si dhe nevojën për inkorporimin e masave të reja alternative, veçanërisht atyre të diversitetit, KDM (2018) ka dyfishuar numrin e masave të diversitetit nga 8 sa ishin, duke quar numrin dhe llojin e masave të diversitetit në 16.

Risi tjetër e kapitullit mbi masat e diversitetit është edhe mënyra dhe kushtet e shqiptimit të masave të diversitetit nga ana e prokurorit të Shtetit për të mitur. Veçantia që vlen të përmendet, tek llojet e masave të diversitetit është se njërën nga masat e diversitetit siç është vërejtja policore e cila nën kushtet e përcaktuar dhe në koordinim me prokurorin e Shtetit për të mitur mund ta cakton edhe zyrtari policor. Gjithashtu është rregulluar edhe mënyra e mbajtjes së evidencës si dhe përcaktimi se evidenca për shqiptimin e masave të diversitetit nuk kanë karakter të evidencës penale në kuptim të Kodit Penal të Kosovës.

¹ Moduli sipas udhëzimeve dhe kërkesave nga partnerët e projektit, është dizajnuar për një nivel të trajnimit bazik mbi masat e diversitetit. Përmbajtja e modulit, poashtu nuk përfaqëson qëndrim zyrtar në lidhje me interpretimet dhe praktikën e ndryshme që janë identifikuar në nivel të Prokurorive Themelore në Republikën e Kosovës në lidhje me procedurat e ndjekura për shqiptimin e masave të diversitetit.

Ky modul është zhvilluar në kuadër të projektit “Rritja e qasjes dhe cilësisë së kujdesit dhe shërbimeve sociale dhe arsimore për vajzat dhe djemtë e cenueshëm, veçanërisht ato në situatë rruge dhe familjet e tyre” mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian në Kosovë në partneritet me Programin e UNICEF-it në Kosovë dhe zbatuar nga Fondacioni Terre des hommes “Lausanne”, në Kosovë.

Ky modul në mënyrë të shkurtë dhe përmbledhëse ofron informata dhe njohuri të kërkuara në lidhje me shqiptimin dhe ekzekutimin e masave të diversitetit, pra përshkruan hapat dhe ofron udhëzimet e nevojshme për një profesionist se si duhet të veprohet që nga momenti kur është kryer vepra penale deri në përfundimin e rastit, me theks të veçantë aspektet procedurale që ndërliidhen me plotësimin e kushteve dhe shqiptimin e masave.

2. SHKURTESA

- **AD**- Akademia e Drejtësisë;
- **MD** - Ministria e Drejtësisë;
- **QPS**- Qendra për Punë Sociale;
- **PSV**-Procedurat Standarde të Veprimit;
- **SHSK** – Shërbimi Sprovues i Kosovës
- **OJQ**- Organizata jo-Qeveritare;
- **LMF** – Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës;
- **KDF** – Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- **KDM** – Kodi i Drejtësisë për të Mitur;
- **KP**- Kodi Penal
- **KPK** – Kodi i Procedurës Penale
- **KGJK**- Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- **KPK** – Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- **OKB** – Organizata e Kombeve të Bashkuara;
- **UNICEF**- Fondi Emergjent i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë;
- **TDH**- Terre des hommes;
- **KDFKB** – Komiteti i të Drejtave të Fëmijës i Kombeve të Bashkuara;

3. OBJEKTIVAT E MODULIT DHE REZULTATET E PRITURA

Objektivat e modulit

Objektivë e përgjithshme e Modulit është ofrimi i materialit trajnues për profesionistët e drejtësisë për të mitur, me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe njohurive për të rritur zbatimin e 16 masave të diversitetit për të miturit në konflikt me ligjin, që rrjedhin nga Kodi i Drejtësisë për të Mitur.

Materiali trajnues synohet që në të ardhmen të përdoret dhe institucionalizohet për trajnime të brendshme nga ana e Akademisë së Drejtësisë (AD).

Rezultat e pritura

Në fund të trajnimit, profesionistët e drejtësisë për të mitur dhe pjesëmarrësit tjerë do të jenë në gjendje:

- Të përvetësojnë konceptet bazë mbi masat e diversitetit;
- Të identifikojnë bazën ligjore ndërkombëtare dhe vendore;
- Të kuptojnë parimet dhe udhëzimet kryesore për mbrojtjen e të miturve;
- Të kuptojnë aspektet procedurale të shqiptimit të masave të diversitetit;
- Të kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë për shqiptimin dhe ekzekutimin e masave të diversitetit;
- Të përvetësojnë njohuri rreth llojeve të reja të masave të diversitetit;
- Të njohin cilat janë përparësitë dhe sfidat e masave të diversitetit;
- Të kuptojnë rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional;
- Të rrisin aftësitë analitike përmes studimit të rasteve praktike etj.

4. MASAT E DIVERSITETIT SI SHMANGIE NGA SISTEMI

Masat e diversitetit apo siç njihen në zhargonin profesional 'diversion measures-masat e shmangies' nënkuptojnë veprimet që profesionistët e drejtësisë për të mitur ndërmarrin për të siguruar që i mituri është shmangur nga procedurat gjyqësore dhe se ai është referuar në shërbime, programe apo aktivitete që janë të bazuara në familje dhe komunitet.

Fjala apo termi 'diversitet' i përdorur nga Kodi i Drejtësisë për të Mitur, edhe pse në aspektin e përkthimit nga gjuha angleze nuk është i duhuri, megjithatë në përmbajtje përmban të gjitha elementet që kërkohen sipas praktikës ndërkombëtare.

Termi i përdorur globalisht 'diversion measure' nëse përkthehet dhe shqipërohet, nënkupton pikërisht qëllimin e këtyre masave që është shmangia nga sistemi i drejtësisë apo masat e shmangies. Shmangia nga sistemi i drejtësisë duhet të jetë kuptimplotë dhe sipas dispozitave ligjore, gjithnjë duke u bazuar në interesin më të mirë të miturit dhe duke synuar gjatë tërë kohës trajtimin dhe rehabilitimin e tij me qëllim të mos përsëritjes së veprave penale.

Koncepti i shmangies funksionon mbi premisën se megjithëse një fëmijë mund të jetë përfshirë në aktivitete të paligjshme, nënshtrimi i tij ndaj sistemit formal të drejtësisë penale është më i dëmshëm dhe rrit gjasat për kryerjen e një veprave penale në të ardhmen.

Shmangia nga sistemi nënkupton edhe vlerësimin dhe trajtimin me profesionalizëm të çdo rasti veç e veç, e të referuar për procedim sipas parimit të interesit më të mirë të fëmijës. Pra, nga konstatimi i vlerësimit edhe vendoset për shmangien apo jo të rastit nga sistemi i drejtësisë. Kjo nënkupton që jo të gjitha rastet i plotësojnë kushtet dhe kriteret për shmangie. Në këtë mënyrë realizohet balancimi i peshojës për trajtimin në mënyrë ligjore dhe të barabartë për kryesin e veprës penale dhe viktimën e kësaj veprave.

Me shmangien nga sistemi i drejtësisë dhe zbatimin e masave të diversitetit, të gjitha palët e përfshira janë fitues. Në njërin anë kemi trajtim dhe rehabilitim të kryesit të mitur, ndërsa në anën tjetër kemi rehabilitim dhe kompenzim të dëmit për viktimën e veprës, dhe në fund kemi një ngritje të efikasitetit të sistemit të drejtësisë në zgjidhjen e shpejtë të rasteve.



5. INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE

Masat e diversitetit sikur edhe të gjitha masat dhe dënimet alternative bazohen dhe rrjedhin nga instrumentet ndërkombëtare tani të njohura dhe të zbatuara edhe në Kosovë. Këto instrumente përbëjnë korpusin e akteve nëpërmjet të cilave synohet rregullimi dhe zbatimi i sigurt i masave të diversitetit dhe masave tjera alternative.

Instrumentet kryesore ndërkombëtare të cilat shërbejnë si rregullator ligjor përfshijnë por nuk kufizohen në:

- Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve;
- Rregullat e OKB-së për standartet minimale për administrimin e Drejtësisë për Fëmijë (Rregullat e Pekinit);
- Rregullat e OKB-së për Parandalimin e kriminalitetit tek të rinjtë (Rregullat e Riadit)
- Parimet Bazë të përdorimit të programeve të drejtësisë restauruese në çështjet penale 2002/12
- Rezoluta 2005/20 Udhëzimet në lidhje me çështje të drejtësisë, të cilat përfshijnë fëmijët viktime dhe dëshmitarë të krimit;
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Veprimet ndaj Fëmijëve në Sistemin e Drejtësisë Penale (1997)
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 10 (2007) mbi “Të drejtat e fëmijëve në drejtësinë për të mitur”;
- Komenti i Përgjithshëm No.12 (2009) mbi “Të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar”;
- Komenti i Përgjithshëm nr.24 (2019) mbi “ Të drejtën e fëmijës në sistemin e drejtësisë”
- Udhëzimet e Këshillit të Europës mbi drejtësinë miqësore për fëmijët.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Në kuadër të standardeve dhe instrumenteve kryesore ndërkombëtare që janë të zbatueshme në Kosovë dhe që rregullojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë aspektet e të drejtave të fëmijës është edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës.

Edhe pse Kosova nuk është nënshkruese e Konventave ndërkombëtare, në nenin 22 të Kushtetutës ka përcaktuar zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, ku së bashku me Konventat tjera ka përfshirë si pjesë të legjislacionit të saj të brendshëm edhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Përveç përfshirjes së Konventës në rendin juridik të Kosovës ajo i ka dhënë përparësi Konventës ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera, ku përcaktohet që:

“Të drejtat dhe liritë e garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike”.



Në kuadër të standardeve dhe instrumenteve kryesore ndërkombëtare që janë të zbatueshme në Kosovë dhe që rregullojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë aspektet e të drejtave të fëmijës është edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF).

KDF në si pjesë e rregullimit të të drejtave të fëmijës në fushën e drejtësisë një rëndësi të veçantë i ka kushtuar edhe aspektit të masave të diversitetit, pikërisht duke i udhëzuar shtetet palë që trajtimi i fëmijëve si kryes të veprave penale të bëhet duke iu shmangur procedurës gjyqësore.

'Shtetet palë, marrin masa, sa herë është e nevojshme dhe e dëshirueshme, për t'i trajtuar këta fëmijë pa iu drejtuar procedurës gjyqësore, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat dhe mbrojtja ligjore. (Neni 40(3.b) i)

Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit)

'Gjithnjë kur është e mundur, do të shqyrtohet mundësia që rastet e kryerësve të mitur të zgjidhen pa gjykim formal para organit kompetent, për çka flitet në rregullën numër 14.1. në tekstin vijues. Policia, prokurori ose organet e tjera që merren me rastet e të miturve do të jenë të autorizuar që rastet t'i zgjidhin në bazë të diskrecionit të vet, pa shqyrtime formale, në bazë të kriterëve të përcaktuara për nevojat e sistemeve përkatëse dhe në bazë të parimeve të përcaktuara në këto rregulla. Për masën e diversitetit që përfshin dërgimin e rastit shërbimeve përkatëse shoqërore ose shërbimeve tjera, është i nevojshëm pajtimi i të miturit ose i prindërve të tij/saj ose kujdestarit, nën kushtin që vendimi i këtillë të jetë objekt i shqyrtimit nga organi kompetent, kur kjo kërkohet. Për të lehtësuar zgjidhjen e rasteve të këtilla të të miturve, do të bëhen përpjekjet të jepen programet e bashkësive lokale, që janë mbikëqyrja e përkohshme dhe udhëzimi, kthimi dhe kompensimi i dëmit të dëmtuarve. (Rregulli 11)

Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Veprimet ndaj Fëmijëve në Sistemin e Drejtësisë Penale (1997)

Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Veprimet ndaj Fëmijëve në Sistemin e Drejtësisë Penale (apo sic njihen si Udhëzimet e Vjenës), ofrojnë si aneks, disa masa gjithëpërfshirëse të cilat duhet të zbatohen me qëllim të krijimit të një sistemi mirë-funksional të administrimit të drejtësisë për të mitur në përputhje me standardet ndërkombëtare. Njëra prej këtyre veprimeve janë edhe masat e diversitetit ku përcaktohet që: "Parandalimin e mbështetjes së tepruar në masat e drejtësisë penale për t'u marrë me sjelljen e fëmijëve, përpjekjet duhet të bëhen dhe orientohen për të krijuar dhe zbatuar programe që synojnë forcimin e ndihmës sociale, që do të mundësonte devijimin (shamngien) e fëmijëve nga sistemi i drejtësisë, sipas rastit, si dhe përmirësimit të zbatimit të masave jo të paraburgimit dhe programeve të riintegritimit. Për të krijuar dhe zbatuar programeve të tilla, është e nevojshme të nxitet bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet sektorëve të drejtësisë për fëmijë, shërbimet e ndryshme të mandatuara për sundimin e ligjit si dhe sektorëve të mirëqenies dhe edukimit." (Udhëzuesi 42).

Parimet bazë të përdorimit të programeve të drejtësisë restauruese në çështjet penale 2002/12

Garancitë themelore procedurale duhet të gjejnë zbatim edhe në programet e drejtësisë restauruese:

(a) Bazuar në ligjin e vendit, viktimat dhe kryerësi duhet të kenë të drejtë për të pasur avokat në lidhje me procesin e drejtësisë restauruese dhe kur është e nevojshme edhe për përkthim. Fëmijët për më tepër duhet të kenë të drejtë të ndihmohen nga prindërit apo kujdestarët;

(b) Përpara se të dakordohen për pjesëmarrjen në procesin e drejtësisë restauruese, palët duhet të informohen mbi të drejtat e tyre, natyrën e procesit dhe pasojat e mundshme të vendimeve të tyre;

(c) As viktimat dhe as kryerësi nuk mund të detyrohen me dhunë apo me mjete të tjera të padrejta për të marrë pjesë apo për të pranuar procesin e drejtësisë restauruese.

14. Diskutimet në proceset e drejtësisë restauruese, të cilat nuk janë kryer në publik duhet të jenë konfidenciale dhe nuk mund të bëhen të njohura për publikun përveç rastit kur palët me marrëveshje kanë rënë dakord për këtë apo kur diçka e tillë është e parashikuar në ligjin e vendit.

15. Rezultatet e arritura në kuadër të një marrëveshje si rezultat i programeve të drejtësisë restauruese duhet të jenë të mbikëqyrura nga gjykata ose duhet të përfshihen si pjesë integrale e akt-vendimeve gjyqësore, rezultatet dhe pasojat e të cilave duhet të jenë të njëjta me ato të akt-vendimeve gjyqësore duke shmangur ndjekjen penale për të njëjtat fakte.

16. Në rast se palët nuk arrijnë marrëveshje mes tyre, çështja duhet ridërguar për shqyrtim gjyqësor penal dhe një vendim me mënyrën e procedimit në vazhdim duhet marrë pa vonesë. Dështimi në arritjen e një marrëveshje nuk mund të përdoret si fakt apo provë në procesin gjyqësor penal në vazhdim.

17. Dështimi në zbatimin e një marrëveshje të bërë në kuadër të një procesi të drejtësisë restauruese duhet të referohet sërish në programet e drejtësisë restauruese ose në sistemin e drejtësisë penale nëse kërkohet nga ligji i vendit në mënyrë që të merret një vendim pa vonesë për mënyrën se si do të procedohet më tej. Dështimi i zbatimit të një marrëveshje, ndryshe nga moszbatimi i një vendimi gjyqësor nuk mund të përdoret si justifikim për një dënim më të rëndë në procesin penal pas ndjekës.

18. Lehtësuesit duhet të përformojnë detyrat e tyre në mënyrë të paanshme duke respektuar dinjitetin e palëve. Në funksion të detyrës së tyre, lehtësuesit duhet të sigurojnë që palët gjithashtu të respektojnë njëra-tjetrën duke i aftësuar ato (palët) për të gjetur një zgjidhje ndërmjet tyre.

19. Lehtësuesit duhet të posedojnë njohuri të mira të kulturës dhe komunitetit lokal dhe atëherë kur është e nevojshme të marrin trajnimin e duhur përpara se të fillojnë detyrën përkatëse.

Udhëzimet mbi Drejtësinë në çështjet të cilat përfshijnë fëmijët viktime dhe dëshmitarë të krimit 2005/20.

III. Parimet

8. Ashtu siç deklarohet në instrumentet ndërkombëtare dhe posaçërisht në Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve, dhe siç është reflektuar edhe në punën e Komitetit të Drejtave të Fëmijëve, në mënyrë që të arrihet drejtësi për fëmijët viktime dhe dëshmitarë të krimeve, profesionistët dhe personat e tjerë përgjegjës për mirëqenien e fëmijëve duhet të respektojnë parimet e mëposhtme:

(a) Dinjiteti. Çdo Fëmijë është unik dhe një qenie njerëzore me vlerë dhe si e tillë dinjiteti dhe nevojat, interesat dhe privatësia e tij ose e saj duhen respektuar dhe mbrojtur;

(b) Mos-diskriminimi. Çdo fëmijë ka të drejtë për tu trajtuar me ndershmëri dhe barazi, pavarësisht racës, etnisë, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, përkatësisë fetare e politike, nacionalitetit, origjinës etnike apo sociale, pasurisë, paaftësisë, statusit të tij (në lindje apo çdo statusi tjetër) apo të prindërve apo kujdestarëve të tij;

(c) Interesi më i Lartë i Fëmijës. Ndërkohë që të drejtat e të akuzuarve apo të dënuarve duhet të garantohen, çdo fëmijë ka të drejtë që interesi i tij më i lartë të jetë si konsideratë parësore. Kjo përfshin të drejtën për tu mbrojtur dhe për të pasur një zhvillim harmonik;

(I) Mbrojtja. Çdo fëmijë ka të drejtën e jetës dhe të mbijetesës dhe për t'u mbrojtur nga çdo formë e vështirësisë, abuzimit dhe neglizhimit;

(II) Zhvillimi harmonik. Çdo fëmijë ka të drejtë për të pasur një mundësi për zhvillim harmonik dhe për një standard jetese të përshtatshme për rritje fizike, mendore, shpirtërore, morale dhe sociale. Në rastin e një fëmije të traumatizuar, hapat duhen ndërmarrë me qëllim aftësimin e tij për një zhvillim të shëndetshëm;

(d) E drejta për të marrë pjesë. Çdo fëmijë bazuar dhe sipas të drejtës procedurale të vendit, ka të drejtën për të shprehur lirisht mendimet, opinionet dhe besimet e tij, me fjalët e tij dhe për të kontribuar sipas pjekurisë dhe kapacitetit intelektual në vendimet që kanë pasojë mbi jetën e tij duke përfshirë ato në procesin gjyqësor.



6. PARIMET UDHËHEQËSE

Kodi i Drejtësisë për të Mitur (Kodi Nr.06/L-006) në kuadër të parimeve themelore (neni 4) ka përcaktuar parime të cilat burojnë nga standardet dhe instrumentet kryesore në fushën e drejtësisë për të mitur, e të cilat në bazë dhe qendër kanë trajtimin, edukimin, rehabilitimin dhe risocializimin e të miturit. Sipas këtij neni, parimet themelore të cilat vlejné përshtatshëmrisht edhe për masat e diversitetit janë këto:

- **Interesi më i mirë i të fëmijës/të miturit**

Duhet të jetë konsiderata mbizotëruese gjatë gjithë procedurës dhe veprimeve që ndërmerren ndaj fëmijës dhe të miturit.

- **Proporcionaliteti i veprimeve**

Sistemi i drejtësisë për të mitur synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që çdo reagim ndaj kryerësve të mitur të jetë gjithmonë në proporcion me rrethanat e kryerësit dhe veprës penale.

- **Alternativat kundruall sanksioneve penale**

Kryerësve të mitur u shqiptohen masat e diversitetit dhe masat edukative, sipas nevojës, duke i dhënë përparësi masave dhe sanksioneve alternative në relacion me sanksionet penale.

- **Privimi nga liria si mjet i fundit**

Privimi nga liria shqiptohet vetëm si mjet i fundit dhe do të kufizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm. Gjatë kohës së privimit nga liria, i shqiptuar si dënim, kryesit të mitur i ofrohet edukim, ndihmë psikologjike, sipas nevojës, edhe ndihmë mjekësore, për ta lehtësuar rehabilitimin e tij.

- **Shprehja e mendimit dhe pikëpamjes**

Fëmijës që merr pjesë në procedurë penale i ofrohet mundësia që të shprehet lirisht.

- **Trajtimi human**

Çdo i mitur i privuar lirie trajtohet me humanizëm për hir të dinjitetit të personalitetit të tij njerëzor, dhe me atë rast merren parasysh nevojat personale të moshës së tij. Në veçanti, çdo i mitur i privuar lirie ndahet nga madhorët, përpos nëse konsiderohet se është në interes të miturit të mos ndahet, dhe gëzojnë të drejtën e mbajtjes së kontakteve me familjen e tij përmes korrespondencave dhe vizitave, përveç rrethanave të jashtëzakonshme të përcaktuara me ligj.

- **Ndihma ligjore dhe profesionale**

Çdo i mitur i privuar lirie ka të drejtë në ndihmë të menjëhershme ligjore dhe ndihmë tjetër adekuate, si dhe të drejtën për të kundërshtuar ligjshmërinë e privimit të tij nga liria pranë një gjykate të pavarur dhe të paanshme, si dhe në procedurë të menjëhershme.

- **E drejta për privatësi**

Për t'iu shmangur lëndimit për shkak të publicitetit të tepruar ose etiketimeve, e drejta e fëmijës për privatësi respektohet në të gjitha fazat. Në parim, nuk publikohet asnjë informacion që shpie në identifikimin e kryerësit të mitur apo riviktimizimin e viktimës.

- **Urgjenca**

Procedura ndaj të miturit dhe procedra në të cilën i mituri është i dëmtuar me vepër penale është urgjente. Organet të cilat marrin pjesë në procedurë ndaj të miturit si dhe organet tjera dhe institucionet nga të cilat kërkohen njoftime, raporte ose mendime, janë të detyruar të veprojnë në mënyrë urgjente.

7. QËLLIMI I MASAVE

Qëllimi i masave të diversitetit është që të parandalojë, kur është e mundur, fillimin e procedurës gjyqësore ndaj kryerësit të mitur, të ndihmojë rehabilitimin pozitiv dhe riintegrimin e të miturit në bashkësinë e tij me qëllim të parandalimit të sjelljes recidiviste. (Neni 19 i KDM)

Pra qëllimi i masave të diversitetit është i shumëfishtë dhe bazohet në konceptin e punës dhe metodologjinë nga prizmi i mbrojtjes së fëmijës që përfshin:

- Parandalimin e procedurës apo siç sqaruam më lartë 'shmangien nga sistemi';
- Ndihmën në rehabilitimin pozitiv;
- Reintegrimin e të miturit pranë komunitetit të tij.

Dhe mbi të gjitha nëpërmjet këtyre masave synohet parandalimi i sjelljeve recidiviste dhe mos kryerja e veprave të reja.



8. KUSHTET PËR SHQIPTIMIN E MASAVE

Kodi i Drejtësisë për të Mitur me hyrjen në fuqi në vitin 2018, në nenin 21 ka sjellë disa risi në kuptim të kushteve për shqiptimin e masave të diversitetit. Risia qëndron tek kushti dhe procedura e caktimit të masës së diversitetit vërejtja policore.

a) Lloji i veprës penale

'Masat e diversitetit mund të shqiptohen nga prokurori, ndaj të miturit i cili ka kryer vepër penale për të cilën është paraparë dënim me gjobë apo me burgim deri në tri (3) vite ose për vepër penale të kryer nga pakujdesia për të cilën është paraparë dënimi deri në pesë (5) vite burgim, me përjashtim të atyre të cilat sjellin si pasojë vdekjen.' (Neni 21, par.1)

b) Kushtet e veçanta për 'vërejtjen policore'


'Masa e vërejtjes policore nga paragrafi 1, nënparagrafi 1.16 i nenit 20 të këtij Kodi mund të caktohet ndaj të miturit si kryes i veprës penale për herë të parë për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me gjobë ose dënimi me burg deri në tri (3) vite.' (Neni 21, par.2)

'Vërejtjen policore si masë të diversitetit e cakton zyrtari policor me lejen e prokurorit të shtetit për të mitur. Policia mban evidencën e vërejtjeve policore të shqiptuara, që nuk kanë karakter të evidencës sikur tek të miturit e dënuar, dhe nuk mund të përdoret në çfarëdo mënyre që do ta dëmtonte të miturin.' (Neni 21, par.3)

c) Kushtet për shqiptimin e masave

KDM përveç caktimit në mënyrë taksative të kushteve që duhet të plotësohen, ka përcaktuar edhe aspektin e plotësimit kumulativ të tyre. Pra, të gjitha kushtet e paraparë në nenin 21 paragrafin 4 duhet të plotësohen në të njëjtën kohë, në mënyrë që të vazhdohet me shqiptimin apo jo të masës së diversitetit:

- pranimi i përgjegjësisë për veprën penale nga i mituri;
- shprehja e gatishmërisë nga i mituri që të pajtohet me palën e dëmtuar dhe
- pëlqimi i të miturit ose i prindit, prindit adoptues ose kujdestarit në emër të të miturit për të zbatuar masën e shqiptuar të diversitetit. (Neni 21, par.4, pikat 4.1, 4.2, 4.3 -KDM)



9. PROCEDURA PËR SHQIPTIMIN E MASËS

Procedura për shqiptimin e masës së diversitetit paraqet momentin më të rëndësishëm në aspektin e zbatimit të masave të diversitetit. Kjo për faktin që Kodi i Drejtësisë për të Mitur ka paraparë disa mënyra apo rrugë që Prokurori i Shtetit mund të zgjedh para se të shqiptojë masën e diversitetit.

Të gjitha këto mënyra apo rrugë janë të ndërtuara dhe udhëhequra nga parimet të cilat i ka paraparë Kodi i Drejtësisë për të mitur:

Parimet kryesore dhe udhëheqëse sipas KDM:

1. Interesi më i lartë i fëmijës si konsiderata mbizotëruese gjatë gjithë procedurës dhe veprimeve që ndërmerren ndaj fëmijës dhe të miturit.
2. Synimin e mirëqenies së të miturit dhe reagimin proporcional ndaj kryerësve të mitur duke konsideruar rrethanat e kryerësit dhe të veprës penale.
3. Dhënien përparësi të masave të Diversitetit dhe masave edukative, sipas nevojës, dhe sanksioneve alternative në raport me dënimin me burgim i cili shqiptohet vetëm si mjet i fundit.

Konform udhëzimeve të parapara në këto parime, KDM ka përcaktuar njërin prej qëllimeve kryesore të masave të diversitetit që lidhet me PARANDALIMIN e FILLIMIT të procedurës gjyqësore ndaj kryerësit të mitur:

'Qëllimi i masave të diversitetit është që të parandalojë, kur është e mundur, fillimin e procedurës gjyqësore ndaj kryerësit të mitur, të ndihmojë rehabilitimin pozitiv dhe riintegrimin e të miturit në bashkësinë e tij me qëllim të parandalimit të sjelljes recidiviste'. (Neni 19 i KDM)

Pra, me shqiptimin e masës së diversitetit synohet mos fillimi i procedurës gjyqësore, nëpërmjet të cilës shmanget mundësia që i mituri të përfshihet në procedura të panevojshme gjyqësore respektivisht mbajtja e të miturit larg procedurave që mund të ndikojnë negativisht në trajtimin dhe edukimin e tij apo saj.

'PARANDALIMI I FILLIMIT TË PROCEDURËS GJYQËSORE':

Procedura Gjyqësore e përcaktuar në këtë nen përfshin të gjitha veprimet që ndërmerren nga institucionet dhe profesionistët e drejtësisë për të mitur në kuptim të vërtetësisë së dyshimit të bazuar. Për më tepër kjo përfshinë të gjitha fazat e procedurës penale, ashtu siç janë përcaktuar në Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe përshtatshmërisht edhe në Kodin e Procedurës Penale. Prandaj, Kodi nuk ka përcaktuar ndonjë fazë në mënyrë taksative, por ka përcaktuar procedurën gjyqësore e cila përfshin të gjitha fazat pa përjashtim.

Me rëndësi:

Pavarësisht mundësive që kanë krijuar dispozitat ligjore në kuptim të procedurave që duhet ndjekur, në parim kërkohet që kurdo që është mundur kjo procedurë fare mos të fillojë, dhe nëse ka filluar të pezullohet, ose pushojë kjo procedurë kurdo që janë krijuar rrethanat për këtë.

Fjalja e ‘...KUR ËSHTË E MUNDUR ...’ i ka dhënë diskrecion Prokurorit të vlerësojë rrethanat dhe plotësimin e kushteve për shqiptimin e masave të diversitetit. Dhe në këtë aspekt, jo rastësisht KDM, ka përcaktuar 3 rrugë apo mundësi të cilat Prokurori i Shtetit mund ti zgjedhë para së të vendos për shqiptimin masave të diversitetit, e në fakt të gjithë këto me disa ndryshime kanë për qëllim shmangien e të miturit sa të jetë e mundur nga sistemi i drejtësisë.

A) Përshtatshmëria apo siç është i njohur si parimi i oportunitetit

‘Për veprat penale të dënueshme me burgim prej më pak se tre (3) vjet ose me gjobë, prokurori i shtetit për të mitur mund të vendosë të mos fillojë procedurën përgatitore edhe pse ekziston dyshim i bazuar se i mituri ka kryer vepër penale, nëse prokurori i shtetit për të mitur mendon se nuk do të ishte e përshtatshme të zbatohet procedura ndaj të miturit për shkak të natyrës së veprës penale, të rrethanave në të cilat është kryer ajo, mungesës së dëmit të rëndë ose të pasojave për të dëmtuarin, si edhe të të kaluarës së të miturit dhe të karakteristikave të tij personale’. (Neni 52 par.2 i KDM)

B) Pezullimi i ndjekjes

‘Prokurori i shtetit për të mitur mund të pezullojë ndjekjen e veprës penale dhe të shqiptojë masën e diversitetit nëse janë plotësuar kushtet nga neni 21 i këtij Kodi. Para vendosjes për masën e diversitetit, prokurori e thërret të miturin, prindin e tij, prindërit adoptues ose kujdestarin dhe mbrojtësin.’. (Neni 49 i KDM)

C) Pushimi i procedurës përgatitore

‘Prokurori i shtetit për të mitur e pushon procedurën përgatitore kurdo që nga provat e mbledhura konstatohet se:

1.4. janë prezente kushtet e parapara në paragrafin 2 të nenit 52 të këtij Kodi’. (56 par.1 nënparagrafi 1.4 i KDM)

Përshtatshmëria apo mos fillimi i procedurës përgaditore në fakt paraqet rrugën dhe mënyrën kryesore të vendosjes për shqiptimin e masës së diversitetit, megjithatë edhe pezullimi i ndjekjes dhe pushimi i procedurës përgaditore janë pjesë e rrugëve dhe mënyrave nëpërmjet të cilat do të duhej të shqiptoheshin masat e diversitetit. Dhe që të trijat si mundësi, nënkuptojnë dhe bëjnë pjesë në qëllimin e përgjithshëm të masave të diversitetit që është parandalimi i procedurave gjyqësore dhe shmangia aty ku është e mundur nga sistemi i drejtësisë për të mitur.

Për diskutim:

1. Cilat do të ishin veprimet që do të duhej ndërmarrë për secilën procedurë të përzgjedhur?
2. Cilat janë përparësitë, vështirësitë dhe pengesat eventuale nga 3 mundësitë e parapara në KDM?
3. Cilat masa do të konsideroheshin si të ekzekutuara në momentin që shqiptohen, dhe, a ekziston një mundësi e tillë?

* Në punëtoritë konsultuese që i kanë paraprirë hartimit të këtij moduli, e ku kanë marrë pjesë prokurorë për të mitur, zyrtarë sprovues, polic, avokat, ndërmjetës etj, është vërejtë se ndërmjet prokurorive themelore ka dilema, dhe ekziston një dallim i madh në aspektin e interpretimit të këtyre tri mundësive që i ka paraparë KDM. Nga ky interpretim jo unik i dispozitave të KDM, është ndikuar edhe praktika e shqiptimit të masave të diversitetit.

* Përderisa nuk ka një interpretim unik dhe zyrtar të këtyre dispozitave, autori i këtij moduli vetëm ka ofruar një përmbledhje të dispozitave që referojnë procedurat dhe rrugët që duhet ndjekur me rastin e shqiptimit të masave të diversitetit, pa paragjykuar qëndrimin apo interpretimin zyrtar në lidhje me këtë qështje.

10. SHQIPTIMI DHE EKZEKUTIMI I TYRE

a) Kush i shqipton masat e diversitetit?

Me ndryshimet e reja të Kodit të Drejtësisë për të Mitur (Kodi Nr.06/L-006), i vetmi autoritet, dhe me diskrecion të plotë për shqiptimin e të gjitha Masave të Diversitetit është Prokurori i Shtetit për të Mitur (me KDM e shfuqizuar edhe Gjykata ka mundur të shqiptojë masë të diversitetit).

Kjo, përfshin edhe masën e diversitetit 'vërejtja policore'. Sepse fjala 'leje' e përcaktuar në këtë dispozitë nënkupton 'delegimin e njëkohshëm të autoritetit dhe diskrecionit' të Prokurorit të Shtetit për të Mitur tek Policia. Pra, leja paraqet një autorizim të jashtëzakonshëm i cili i jipet policisë për të caktuar vërejtjen policore. Prandaj, edhe ligdhënësi me kujdes ka përdorur termin 'cakton' nga termi 'shqipton' që është diskrecion dhe autoritet i përcaktuar vetëm për Prokurorin e Shtetit për të Mitur.

Kujdes:

Sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur Kodi nr.03/L-193 i vitit 2010 tanimë i shfuqizuar, edhe Gjykata ka mundur të shqiptojë masat e diversitetit.

Fatkeqësisht sipas raporteve zyrtare, del që në disa raste akoma edhe Gjykata është duke shqiptuar masë diversiteti. Kjo praktikë duhet të ndërpritet sepse këto vendime janë në kundërshtim me dispozitat e KDM dhe si të tilla konsiderohen si vendime të jashtëligjshme.

b) Kush i ekzekuton dhe mbikëqyrë masat e diversitetit?

Masat e diversitetit i ekzekuton Shërbimi Sprovues i Kosovës. Roli i Shërbimit Sprovues është shumë i rëndësishëm, pasi sipas ligjit janë zyrtarët sprovues të cilët janë të mandatuar të kryejnë në përgjithësi procesin e mbikëqyrjes së sjelljes dhe mbarvajtjes së programeve që i mituri ndjek nga monenti kur fillon ekzekutimi i masës së diversitetit, e vazhdon me mbikëqyrjen dhe lehtësimin e procesit të riintegritimit duke përfshirë edhe punën me familjen, pritjen në komunitet dhe gjetjen e mundësive dhe modaliteteve që kërkohen nga detyrimet e përcaktuara nga masa e diversitetit.

Ekzekutimi i masës së diversitetit

Shërbimi Sprovues i Kosovës është institucion që merret me organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative, mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht, si dhe punë të tjera të përcaktuara me ligj. (Neni 3, par.1. Nënparagrafi 1.1)

Shërbimi Sprovues i Kosovës është Agjenci ekzekutive e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe është i pavarur në kryerjen e funksionit të vet në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore. Misioni i Shërbimit Sprovues të Kosovës është ekzekutimi i masave dhe dënimeve alternative në rehabilitimin, reintegrimin dhe risocializimin e personave të cilëve organet kompetente të drejtësisë i kanë shqiptuar masë apo dënim alternativ.

⁵ Neni 21 par.3 '3. Vërejtjen policore si masë të diversitetit e cakton zyrtari policor me lejen e prokurorit të shtetit për të mitur.'

⁶ Shih raportin e Prokurorit të Shtetit për vitin 2022

⁷ <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/RAPORTI%20VJETOR%20I%20PROKURORIT%20TE%20SHTETIT%202022.pdf>

⁷ Ligji Nr.08/L-129 për Shërbimin Sprovues të Kosovës.

Sipas Ligjit për Shërbimin Sprovues, Shërbimi Sprovues ndër të tjera, kanë këto përgjegjësi:

1. Shërbimi Sprovues është përgjegjës për kryerjen e punëve lidhur me:
 - 1.4. ekzekutimin e masave të diversitetit dhe masave edukative për të mitur;
 - 1.8. zhvillimi i programeve individuale të mbikëqyrjes siç përcaktohet me legjislacionin përkatës në fuqi;
 - 1.9. hartimin e raporteve për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative si dhe personave të liruar me kusht për Prokurorin e Shtetit, Gjykatat dhe Panelin për Lirim me Kusht;
 - 1.11. mbajtjen e evidencave dhe regjistrave për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative si dhe raporteve;
2. Shërbimi Sprovues bashkëpunon me organet e pushtetit qendror dhe lokal, personat juridik dhe me institucione tjera relevante në zbatimin e mbikëqyrjes. (Neni 6)

Sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur:

'Shërbimi Sprovues e informon menjëherë organin kompetent i cili e shqipton masën e diversitetit për moskryerjen e detyrimeve të masës së diversitetit nga i mituri i cili mund të vendosë për rifillimin e ndjekjes së rastit. (Neni 21 par.5 Kodi i Drejtësisë për të Mitur (Kodi Nr.06/L-006))

'Kur prokurori i shtetit për të mitur, shqipton masën e diversitetit, aktvendimi dhe të gjitha informacionet dërgohen në shërbimin sprovues kompetent për ekzekutimin e kësaj mase.'

'Nëse i mituri nuk e përmbush detyrimin e urdhëruar si masë diversiteti, shërbimi sprovues verifikon faktet dhe arsyet e mos përmbushjes së detyrimit dhe e informon prokurorin e shtetit për të mitur që e ka shqiptuar masën e diversitetit (Neni 74, par.1 dhe 3 Kodi i Drejtësisë për të Mitur (Kodi Nr.06/L-006))

Mbikqyrja e ekzekutimit të masës së diversitetit

Përveç ekzekutimit që e bën Shërbimi Sprovues i Kosovës, një diskrecion dhe rol të veçantë Kodi i Drejtësisë për të Mitur i ka dhënë Prokurorit të Shtetit për të mbikëqyrë ekzekutimin e masës së diversitetit.

'Prokurori i shtetit për të mitur e mbikëqyrë ekzekutimin e masës së diversitetit. (Neni 74, par.1 dhe 3 Kodi i Drejtësisë për të Mitur (Kodi Nr.06/L-006))'

Përfundimisht nga ekzekutimi i masave të tjera të diversitetit bën "Vërejtja Policore", të cilën me rastin e caktimit e ekzekuton Policia. Sipas KDM pas caktimit të masës, policia obligohet që këto raste të evidentojë: (... Policia mban evidencën e vërejtjeve policore të shqiptuara, që nuk kanë karakter të evidencës sikur tek të miturit e dënuar, dhe nuk mund të përdoret në çfarëdo mënyre që do ta dëmtonte të miturin.' (Neni 21 par.3 Kodi i Drejtësisë për të Mitur (Kodi Nr.06/L-006))'

⁸ <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,19> (qasur në Nentor 2023)

⁹ Ligji Nr.08/L-129 për Shërbimin Sprovues të Kosovës.

c) Koha e ekzekutimit të masës së diversitetit

Kohëzgjatja e masës së diversitetit varet nga lloji i saj:

Afatshkurta

Lloji i masës	Kohëzgjatja e ekzekutimit
<ul style="list-style-type: none">• Pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar;• Pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij;• Kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjelltë ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit;• Pagesa e një shume të caktuar të të hollave të destinuara për qëllime bamirësie apo në programin për kompensim të viktimave në përputhje me situatën financiare të të miturit• Vërejtja policore.	<p>Kohëzgjatja e tyre mund të jetë e shkurtë, dhe mund të ekzekutohet me vet shqiptimin e masës.</p>

Afat mesme dhe afat gjatë

Lloji i masës	Kohëzgjatja e ekzekutimit
<ul style="list-style-type: none">• Vijimi i rregullt në shkollë;• Pranimi i punësimit apo aftësimin në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij;• Edukimi në rregullat e trafikut;• Këshillimi psikologjik;• Angazhimi në aktivitete sportive dhe rekreative;• Këshillimi ndërmjet familjeve të të miturve;• Të përmbahet nga çfarëdo kontakti me individë të caktuar që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri;• Të mos vizitojë vende ose mjedise të caktuara që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri;• Të përmbahet nga përdorimi i drogës dhe i alkoolit.	<p>Kohëzgjatja e tyre mund të jetë me një afat të mesëm apo të gjatë, varësisht prej llojit të programit dhe trajtimit që përcaktohet nga profesionistët e fushës. Përkundër që koha nuk është e përcaktuar, ajo duhet të jetë në interesin e të miturit për trajtim dhe rehabilitim. Në momentin që vlerësohet që është arritur qëllimi i masës së diversitetit, duhet të konsiderohet që masa është ekzekutuar mesukses.</p>

Përfashtim:

I vetmi përfashtim sipas KDM në aspektin kohor, është masa e diversitetit – “kryeja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme” e cila mund të shqiptohet në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë si dhe me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej minimum (10 orë) dhe maksimum (60 orë). Pra sipa kësaj mase intervali kohor duhet të jetë ndërmjet minimumit dhe maksimumit.

Këshillë:

Masa e diversitetit ‘kryeja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme edhe pse në emërtim është e ngjajshme me dënimin ‘urdhëri për punë në dobi të përgjithshme’ ato janë të ndryshme në shumë aspekte dhe nuk duhet të ngatrohen në zbatimin e tyre në praktikë.

Megjithëse kohëzgjatja apo zbatimi masave të diversitetit (përfashtim 'puna në dobi të përgjithshme) nuk është përcaktuar sipas KDM, kjo nuk nënkupton që prokurori i Shtetit për të Mitur nuk ka të drejtë të caktojë afate dhe udhëzime për zbatim. Përkundrazi, është në diskrecionin e prokurorit të Shtetit për të mitur që konform interesit më të mirë të të miturit dhe rethanave të rastit të caktojë afate, kushte dhe të jep udhëzime për mënyrën e ekzekutimit të masave të diversitetit.

d) A mund të kombinohen masat ndaj një të mituri?

Neni 19 dhe 20 i KDM përveç që nuk përfashton dhe nuk e ndalon kombinimin e tyre, ai përdor gjuhë në shumës ‘...masat e diversitetit mund ti shqiptohen ...’ që krijon mundësi për prokurorin e Shtetit për të mitur që aty ku është e mundur dhe që është në interesin më të mirë të të miturit ti kombinohen masat. Pra kombinimi i masave është i lejuar dhe i mirësardhur.



c) Koha e ekzekutimit të masës së diversitetit

Kohëzgjatja e masës së diversitetit varet nga lloji i saj:

Afatshkurta

Shembull

Kombinimi i masës 1.1 Pajtimi ndërmjet kryesit dhe të dëmtuarit si dhe masës 1.3 kompenzimi i dëmit palës së dëmtuar..... do të ishte i mundur dhe në interesin e të miturit! Sepse, me ekzekutimin e tyre, do të bëhej edhe ndërgjegjësimi dhe vetëdijësimi i kryesit të mitur në një rënë anë, dhe do të arrihej edhe zhdëmtimi nëpërmjet kompenzimit të dëmit të shkaktuar ndaj të dëmtuarit në anën tjetër. Pra, me zbatimin e këtyre masave do të arrihej ndikimi afatgjatë në rehabilitimin pozitiv dhe do të sigurohej që i mituri nuk do të kryente vepra penale në të ardhmen, si dhe eliminimin e mundësive që pala e dëmtuar të kërkojë ta realizojë të drejtën e tij për kompenzimin e dëmit të shkaktuar.

ose...

Kombinimi i masës 1.4 Vijimi i rregullt në shkollë dhe masës 1.5 Pranimi i punësimit apo aftësimin profesional Këto dy masa, përveç që do të ndikonin në sigurimin e vijueshmërisë në shkollë, do të mundësonin të miturit ndjekjen e ndonjë aftësimi profesional përmes shkollimit të rregullt apo edhe të ndonjë kursi profesional nga të cilat i mituri do të përfitonte shkathtësi dhe aftësi për jetën e pavarur.

Kodi nuk e përjashton kombinimin e masave të diversitetit. Kombinimi është i mundshëm dhe i dobishëm. Para së gjithash, gjatë gjithë kohës vlerësimi më i rëndësishëm është interesi më i mirë i të miturit. Pra kombinimi është i mundur, përcaktimi për llojet e masave që do të shqiptohen të miturit duhet të paraprijnë rethanave dhe nevojave të të miturit për të përmbushur dhe eliminuar shkaqet që kanë shtyer atë në kryerjen e veprës penale.

e) A mund të shqiptohet më tepër së një herë masa e diversitetit?

KDM nuk ndalon shqiptimin më tepër së një herë të masës së diversitetit. Nëse kjo është në interesin e të miturit dhe pas vlerësimit të rethanave dhe kushteve, prokurori për të mitur mund të shqiptojë me tepër se një herë masën e diversitetit. Vendimi për shqiptim apo jo, është në diskrecion të plotë të prokurorit të shtetit për të mitur.

11. LLOJET E MASAVE TË DIVERSITETIT (RISITË)

KDM përveç 8 llojeve të masave të diversitetit që kanë ekzistuar me KDM e vitit 2010, ka shtuar edhe 8 lloje të reja të masave të diversitetit. Masat e reja janë risi dhe reflektojnë nevojën dhe mundësitë që duhet ti ofrohen fillimisht të miturit por edhe profesionistëve në arritjen e qëllimit të trajtimit dhe reintegrimit të sukseshëm të miturit.

Afatshkurta

Ekzistueset	Risitë
<ul style="list-style-type: none">• Pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar;• Pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij;• Kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjelltë ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit;•• Vijimi i rregullt në shkollë;• Pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij;• Kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë. Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në gjashtëdhjetë (60) orë;• Edukimi në rregullat e trafikut;• Këshillimi psikologjik.	<ul style="list-style-type: none">• Angazhimi në aktivitete bamirësie;• Pagesa e një shume të caktuar të hollave të destinuara për qëllime bamirësie apo në programin për kompensim të viktimave në përputhje me situatën financiare të të miturit;• Angazhimi në aktivitete sportive dhe rekreative;• Këshillimi ndërmjet familjeve të të miturve;• Të përmbahet nga çfarëdo kontakti me individë të caktuar që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri;• Të mos vizitohet vende ose mjedise të caktuara që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri;• Të përmbahet nga përdorimi i drogës dhe i alkoolit;• Vërejtja policore

12. PËRZGEDHJA DHE ZBATIMI

1.1. Pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar;

1.2. Pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij.

Këto dy masa përkundër faktit që janë përcaktuar në KDM si masa të diversitetit, zbatimi dhe ekzekutimi i tyre mund të realizohet përshtatshëm sipas metodave dhe procedurave të parapara për Ndërmjetësimin. Pra, ato paraqesin dhe përmbajnë në tërësi elemente të ndërmjetësimit.

Parimet, rregullat, afatet kohore, marrëveshja dhe të gjitha detajet që vlejné për ndërmjetësimin si procedurë jashtëgjyqësore vlejné dhe mund të përdoren përshtatshëm edhe tek këto dy masa të diversitetit.

Përfundim nga këto rregulla bëjnë rastet kur pajtimi arrihet aty për aty në polici apo tek prokurori, në këto raste nuk ka nevojë të zhvillohet procedurë e veçantë e ndërmjetësimit, ajo mund të shënohet në procesverbal apo aktvendim për shqiptimin e masës, duke konstatuar që kjo masë është përmbjllur me sukses në momentin që i mituri dhe pala e dëmtuar janë pajtuar si dhe është kërkuar falje. E njëjta vlen edhe tek pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij.

1.3. Kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjelltë ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit.

Çka kompensohet?

KDM nuk precizon se për cilin dëm është fjala. Andaj, duhet të merret se kompensimi i përket si dëmit material, ashtu edhe dëmit jomaterial.

Kush është i dëmtuari?

I dëmtuari mund të jetë person fizik ose person juridik.

Si bëhet kompensimi?

Kompensimi bëhet me pagesë të kundërvlerës së dëmit të shkaktuar, pra me dhënien e shumës së caktuar të të hollave. Përfundimisht kompensimi mund të bëhet edhe nëpërmjet kryerjes së ndonjë veprimi i cili nuk përfshin pagesën financiare, si p.sh: rregullimi i makinës së dëmtuar, nëse i mituri ka përvojë(zanat) në rregullimin e makinave apo diqka të ngjajshme.

Si arrihet marrëveshja?

Përfundimi i marrëveshjes në formë të kontratës me shkrim apo ndonjë formë tjetër nuk është i domosdoshëm. Mjafton edhe marrëveshja gojore, por për të gjitha çështjet qenësore, siç janë lartësia e saktë, mënyra dhe vendi i pagimit të dëmit etj., e cila konstatohet në procesverbal dhe në aktvendim.

Pse edhe përfaqësuesi ligjor?

KDM parasheh se në marrëveshje duhet të marrë pjesë edhe përfaqësuesi ligjor i të miturit. në këtë mënyrë, ai është i njoftuar për veprën penale, për ofrimin e shqiptimit të masës së diversitetit, ka dijeni për situatën financiare të të miturit dhe përmes tij ekzekutimi i masës më lehtë mbikëqyret.

Situata financiare e të miturit

Masa e diversitetit të kompensimit të dëmit shqiptohet në përputhje me gjendjen financiare të të miturit e jo të familjes së tij. kjo do të thotë se:

- mund të shqiptohet vetëm nëse i mituri ka pasuri/të ardhura personale;
- marrëveshja mund të arrihet edhe për kompensimin e pjesëshëm të dëmit, nëse i mituri nuk ka pasuri të mjaftueshme për kompensimin e dëmit në tërësi;
- nëse i mituri ka ndonjë profesion apo zanat e që nëpërmjet tij mund ta kompenzon dëmin pa vlerë monetare.

1.4. Vijimi i rregullt në shkollë.

Kohëzgjatja

Vijimi i rregullt i shkollës nuk ka kohëzgjatje të caktuar me KDM. Megjithatë, duhet të merret se kohëzgjatja ka të bëjë së paku me përfundimin e vitit shkollor, në të cilin masa është shqiptuar, ose deri sa prokurori i cili e ka shqiptuar të bindet se efekti i masës te i mituri është realizuar, por pa ndonjë përkufizim të posaçëm kohor.

Lloji i veprave penale

Vijimi i rregullt i shkollës duhet të shqiptohet për veprat penale, të cilat kanë pasojë e mosvijimit e rregullt të shkollës dhe, rrjedhimisht, me situata siç janë shoqërimi me personat që kanë ndikim negativ te i mituri, mosrespektimi i autoritetit të shkollës e as të prindit, etj. Mosvijimi i shkollës mund të jetë i pjeshëm apo edhe i plotë kur fëmija ka braktisur shkollën.

Kush konsultohet dhe njoftohet?

Është shumë e kuptueshme se para shqiptimit të masës së diversitetit të vijimit me rregull të shkollës, nëse i mituri është nxënës, paraprakisht duhet të sigurohet raporti nga shkolla duke bërë një vlerësim të kaluarës së të miturit në kuptimin edukativ dhe mësimor. Njëkohësisht, gjatë ekzekutimit të masës, prokurori i cili ka shqiptuar masën dhe Shërbimi Sprovues duhet të jenë në kontakte të vazhdueshme me drejtorin e shkollës, kujdestarin e klasës ose arsimtarët, sepse kjo është e domosdoshme për të kuptuar efektin e masës së shqiptuar. Mirëpo, për shkak të mbrojtjes së interesit të të miturit, kjo informatë medoemos duhet të jetë konfidenciale.

Ku ekzekutohet?

Ekzekutimi i kësaj mase në parim duhet të bëhet në shkollën e fundit ku i mituri ka qenë duke vijuar mësimin, e nëse kjo nuk është e mundur, apo është në interesin e të miturit për t'ia ndëruar shkollën, atëherë Shërbimi Sprovues duhet të vendos në bazë të një vlerësimi të rethanave dhe gjithnjë duke u bazuar në interesin më të mirë të miturit.

1.5. Pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathhtësitë e tij.

Krahasimi me punën me interes të përgjithshëm

Në të dy rastet fjala është për obligimin e të miturit që të punojë (gjegjësisht këtu ose të aftësohet për profesionin e caktuar). Megjithatë, dallimet janë të shumta.

Punësimi është themelimi i marrëdhënies së punës. Karakteri i punës nuk është i caktuar me KDM, përveç që duhet t'iu përgjigjet aftësive dhe shkathhtësive të të miturit. Ndërkaq, masa e punës me interes të përgjithshëm gjithnjë paraqet punë, nga e cila interes ka shoqëria, pra është me interes të përgjithshëm.

Punësimi është me pagesë, ndërsa puna me interes të përgjithshëm është pa pagesë. Punësimi themelohet për kohë të caktuar ose të pacaktuar, ndërsa puna me interes të përgjithshëm është më e shkurtër dhe zgjat më së shumti 60 orë.

Nuk është detyrim

Pranimi i punësimit ose i aftësimit për profesion, i cili është adekuat me aftësitë dhe shkathhtësisë e të miturit, nuk është punë/ aftësim me detyrim. Të gjitha shpjegimet e dhëna për punën me interes të përgjithshëm lidhur me pëlqimin e të miturit (ose të përfaqësuesit të tij ligjor) vlejnë edhe këtu.

Mosha e të miturit dhe mbrojtja e tij

Masa e diversitetit e pranimit të punësimit mund të shqiptohet ndaj të miturit të moshës, e cila është e përcaktuar me ligjin përkatës të marrëdhënies së punës dhe konventat dhe standardet ndërkombëtare në lidhje me punësimin e fëmijës.

I mituri nuk mund të punësohet apo angazhohet në asnjë formë e cila mund të ndikojë në edukimin, mirëqenien dhe shëndetin e tij apo saj.

Çka kuptohet me "aftësim"?

Me fjalën aftësim duhet të kuptohet shkollimi, vijimi i kursit, i stërvitjeve, ligjëratave, ushtrimeve ose aktiviteteve të ngjashme, me qëllim që i mituri të përgatitet/aftësohet për profesionin e caktuar. Këtu, sikurse te punësimi, bëhet fjalë për profesionin i cili u përgjigjet aftësive dhe shkathhtësive të të miturit.

Çfarë është lloji i punës/aftësimit dhe kush vendos?

KDM nuk precizon llojin e punës ose të aftësimit, por vetëm se duhet t'iu "përgjigjen aftësive dhe shkathhtësive të të miturit". Kjo mundëson fleksibilitet gjatë vendosjes. Se si merret informata për mundësitë e punësimit apo të aftësimit, KDM po ashtu nuk precizon. Subjekti, i cili shqipton këtë masë të diversitetit, ndoshta duhet të mbështetet në informatat e marra nga Shërbimi Sprovues dhe organi i kujdestarisë, si dhe nga burime të tjera.

Kohëzgjatja

As kohëzgjatja e kësaj mase të diversitetit nuk është e caktuar me KDM. Prokurori i cili ka shqiptuar këtë masë të diversitetit, përmes Shërbimit Sprovues duhet të përcjellë se i mituri a kryen punën (këtu pranimin e punësimit nuk duhet kuptuar vetëm si një akt, por edhe vetë punën, pra si një vazhdimësi dhe tërësi) një kohë të arsyeshme (ca muaj), ndërsa aftësimi zgjat aq sa është e nevojshme për t'u arritur rezultati i kërkuar.

1.6. Kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë. Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në gjashtëdhjetë (60) orë.

Kush duhet të vendosë për llojin e punës?

Përderisa prokurori, i cili ka shqiptuar këtë masë vendos për kohëzgjatjen e saj, Shërbimi Sprovues e përcakton llojin e punës, cakton organizatën specifike ku do të kryhet puna dhe vendos për ditë të javës kur puna do të kryhet.

Dobia e përgjithshme

Puna pa pagesë në dobi të përgjithshme shqiptohet kur me vepër penale është cenuar interesi i përgjithshëm dhe jo i individit. Andaj, edhe puna duhet të kryhet ashtu që dobi të ketë jo individ, por shoqëria në përgjithësi.

Nuk është punë me detyrim

Puna pa pagesë me dobi të përgjithshme nuk është punë me detyrim. Mendime të kundërta janë shprehur nga prokurorë, me argumentim se i mituri detyrohet të kryejë punën e caktuar, sepse, në të kundërtën, ndaj tij do të fillohet ose vazhdohet procedura penale dhe se kjo paraqet mosrespektim flagrant të të drejtave të njeriut.

Mendimi i këtillë nuk ka mbështetje në KDM. Kryerja e punës, sikurse edhe masat e tjera të diversitetit, janë ofertë ndaj të miturit. Atij i ofrohet të kryejë punën sipas rregullave ligjore dhe vërtet moskryerja e punës për pasojë ka fillimin apo vazhdimin e procedurës penale ndaj tij, mirëpo, puna shqiptohet pas marrjes së pëlqimit të të miturit (ose të përfaqësuesit të tij ligjor), që është kusht i pashmangshëm të shqiptimit të masave të diversitetit. Në anën tjetër, i mituri nuk ngarkohet me punë të rëndë, e cila nuk iu përgjigjet mundësive dhe aftësive të tij psikofizike dhe moskryerja e punës për shkaqe të arsyeshme nuk tërheq fillimin ose vazhdimin e procedurës penale ndaj tij.

A mund të ndryshohet- ndërprehet, kur është në ekzekutim?

Nëse të miturit i është shqiptuar masa e diversitetit, aktvendimi dhe të gjitha informacionet e tjera i dërgohen Shërbimit Sprovues. Prokurori i cili e ka shqiptuar e mbikëqyr ekzekutimin e masës së diversitetit. Kjo do të thotë se nga Shërbimi Sprovues ose institucionet-personat e tjerë, gjithherë mund të kërkohet informatë për rrjedhën e ekzekutimit. Në anën tjetër, nëse i mituri nuk përmbush detyrimin e urdhëruar si masë e diversitetit, pra punën e caktuar, Shërbimi Sprovues verifikon faktet dhe arsyet e mospërmbushjes së detyrimit dhe e informon prokurorin, i cili e ka shqiptuar masën e diversitetit.

Del se i vetmi autoritet, i cili vendos për rrjedhën e ngjarjeve, është ai i cili e ka shqiptuar masën. Mospërmbushja e obligimit çdo here nuk tërheq fillimin e procedurës penale, sepse mund të jetë pasojë e pengesave objektive, të cilat janë paraqitur gjatë ekzekutimit të masës. Andaj, nuk ka pengesa ligjore që ekzekutimi i masës së punës në dobi të përgjithshme të ndërprehet apo të ndryshohet (p.sh. të ndryshohet organizata në të cilën puna kryhet, apo të zvogëlohet numri i orëve të punës, etj.).

1.7. Edukimi në rregullat e trafikut.

Ku zhvillohet dhe çka përmbanë?

Edukimi në rregullat e trafikut është masë e diversitetit që nënkupton marrje të diturisë në rregullat e trafikut rrugor.

Edukimi duhet të zhvillohet në shkollë për aftësimin për vozitje ose institucionin tjetër përkatës (në vazhdim "institucioni") dhe përfshinë edukimin teorik dhe praktik lidhur me rregullat e përgjithshme të trafikut rrugor.

Seleksionimi

Kjo masë e diversitetit duhet ti shqiptohet në rend të parë të miturit i cili ka kryer veprë penale kundër sigurisë së trafikut rrugor, por edhe të mitorve tjerë kur është në interesin e tyre, në mënyrë që të parandalohet kryerja e veprave të ngjashme penale dhe recidivizmi.

A parashihet provimi?

Në rastin konkret nuk është e nevojshme të mbahet provimi klasik për vozitës e as që i mituri obligohet të dal në testin për vozitës, por nënkupton vlerësimin e diturisë së tij të përfituar, nga personi/at profesionist të cilit i përcakton institucioni, pas përfundimit të edukimit.

Shërbimi sprovues dërgon raport për kryerjen me sukses të kësaj mase, duke u mbështetur në rezultatet e mbikqyrjes së masës, në bashkëpunim me institucionin në të cilin zbatohet edukimi.

Kohëzgjatja

Sikurse te masat e tjera të diversitetit, kohëzgjatja e edukimit në rregullat e trafikut nuk mund të përcaktohet paraprakisht dhe të jetë rregull. Duhet të zgjasë aq kohë sa është e nevojshme që i mituri të përfitoj njohuri të përgjithshme për rregullat e trafikut rrugor. Nëse i mituri ka njohuri paraprake atëherë edhe kohëzgjatja e masës së diversitetit duhet të jetë më e shkurtë.

Masa duhet të ekzekutohet në mënyrë që të mos pengohet shkollimi ose aktivitetet tjera me interes tek i mituri.

Marrëveshja me institucionin

Në mes të Shërbimit Sprovues dhe institucionit duhet të ekzistoj një lloj marrëveshje, që institucioni të pranoj të miturin dhe t'i ofroj edukimin në fjalë. Shërbimi Sprovues, ngjashëm sikur te masa e diversitetit të punës pa pagesë me interes të përgjithshëm duhet të ketë listën e institucioneve të cilat pajtohen të ofrojnë këtë shërbim.

Konfidencialiteti

Institucioni duhet të njoftohet për konfidencialitetin e procedurës ndaj të miturit dhe t'i tërhiqet vërejtja që mos të publikoj se i mituri i cili i nënshtrohet edukimit, është kryes i veprës penale.

Konflikti i interesave

Personi i cili është caktuar nga institucioni që të kryej edukimin e të miturit në rregullat e trafikut dhe personi që bënë vlerësimin e njohurive që i mituri ka përfituar, nuk mund të jetë personi i cili është palë në procedurë penale ndaj të miturit. Kjo vlenë edhe për personat tjerë të cilët sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale nuk mund të dëgjohen në cilësi të dëshmitarit apo ekspertit që është i liruar nga obligimi i dëshmisë, gjegjësisht dhënjes së konstatimit dhe mendimit si ekspert.

1.8. Këshillimi psikologjik.

Ku zhvillohet këshillimi psikologjik dhe çka përmban?

Këshillimi psikologjik është masë e diversitetit që nënkupton obligimin e të miturit që në intervale të caktuara kohore të vizitoj psikologun dhe të këshillohet me të. Këshillimi është pranimi dhe zbatimi i këshillave nga psikologu për pjesëmarrje aktive të të miturit në biseda dhe tretman tjetër të caktuar nga psikologu. Këshillimi duhet të zhvillohet në klinikë, në ordinancën e psikologut ose në vend tjetër të përshtatshëm, sipas marrëveshjes. Vendi duhet të mos të dallojë nga vendet ku zakonisht bëhen këshillimet, në mënyrë që i mituri të mos të ekspozohet, posaçërisht duke ditur se kjo masë e diversitetit shqiptohet ndaj të miturit i cili ka nevojë për këshillim psikologjik.

Seleksionimi

Sikuse u përmend më lart, kjo masë e diversitetit duhet të shqiptohet në rend të parë të miturit i cili ka nevojë për këshillim psikologjik, dhe kur vlerësohet se si pasoja e sjelljes së caktuar të të miturit ka ardhë deri tek kryerja e veprës penale, e nëpërmjet këshillimit psikologjik do të eliminohej ajo sjellje. Mund t'ju shqiptohet edhe të miturve tjerë, sidomos të miturve të cilit nuk kanë pengesa të lartcekura por jetojnë në kushte të cilat mund t'i nxisin për veprime të atilla. Në këtë mënyrë do të synohet të parandalohet kryerja e veprave penale dhe recidivizmi.

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e masës nuk mund të jetë fikse por duhet të zgjasë aq kohë sa është e nevojshme që të përfundojë një këshillim i suksesshëm psikologjik. Vlerësimin e bënë psikologu i cili njëkohësisht realizon këshillimin psikologjik. Shërbimi Sprovues dërgon raportin për kryerjen a mos kryerjen me sukses të kësaj mase, duke u mbështetur në rezultatet e mbikqyrjes së masës, në bashkëpunim me psikologun përkatës i cili e zbaton këshillimin. Ekzekutimi i masës duhet të bëhet në atë mënyrë që të mos pengohet shkollimi ose aktivitetet tjera me interese parësor për të miturin.

Marrëveshja me psikologun

Në mes të Shërbimit Sprovues dhe psikologut duhet të ekzistojë një lloj marrëveshje, për pranimin e të miturit dhe ofrimin të këshillimit në fjalë.

Shërbimi Sprovues, ngajshëm sikurse tek masa e diversitetit të punës pa pagesë me interes të përgjithshëm, edukimi në rregullat e trafikut, etj., duhet të ketë listën e psikologëve të licencuar të cilë pajtohen dhe janë kompetent të ofrojnë shërbime të këshillimit psikologjik.

Zyrtari i Shërbimit Sprovues i cili me profesion është psikolog, nuk mund të angazhohet si psikolog për zbatimin e kësaj mase të diversitetit, por mund të caktohet si person nga Shërbimi Sprovues i cili kontakton me psikologun përkatës i cili e këshillon të miturin por ky zyrtar nga Shërbimi Sprovues e mbikqyr zbatimin e masës së këshillimit psikologjik.

Konfidencialiteti

Psikologu duhet të njoftohet për konfidencialitetin e procedurës ndaj të miturit dhe t'i tërhiqet vërejtja që të mos publikoj se i mituri i cili i nënshtrohet këshillimit, është kryes i veprës penale.

Konflikti i interesave

Psikologu nuk mund të jetë person i cili është palë në procedurë penale ndaj të miturit. Kjo vlenë edhe për personat tjerë të cilët sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale nuk mund të dëgjohen në cilësi të dëshmitarit apo ekspertit që është i liruar nga obligimi i dëshmisë, gjegjësisht dhënjes së konstatimit dhe mendimit si ekspert.

1.9. Angazhimi në aktivitete bamirësie.¹¹

Çka përmban kjo masë?

Masa e Diversitetit për angazhim në aktivitete bamirësie është një masë tipike që synon të inkurajojë ndërgjegjësimin dhe përgjegjshmërinë qytetare tek i mituri kryerës. Kjo masë është sidomos shumë e rëndësishme nëse vepra penale ka prekur apo dëmtuar një individ, komunitet apo grup shoqëror të caktuar.

Çfarë angazhimi?

Angazhimi i të miturit në aktivitete që kanë në thelb bamirësinë, është një mënyrë shumë e mirë për të rritur tek i mituri qoftë ndjenjën e empatisë për persona të tjerë, të cilat kanë nevojë për mbështetje, qoftë marrjen e përgjegjesisë për veprimet që ka kryer. Psh. nëse i mituri ka kryer një sjellje të gabuar kundrejt personave me aftësi të kufizuara apo personave të moshuar do të ishte shumë e përshtatshme që aktivitetet e bamirësisë të fokusoheshin në drejtim të përkujdesjes kundrejt këtyre grupeve.

Dallimi me masat e diversitetit: 1.3; 1.5; 1.6; dhe 1.10.

Një element i rëndësishëm gjithashtu, i cili synohet të arrihet nëpërmjet kësaj mase është zhdëmtimi apo shpagimi i dëmeve të krijuara ndaj komunitetit apo shoqërisë. Në këtë drejtim kjo masë ngjason me masën e diversitetit të punës pa pagesë në dobi të përgjithshme, dhe masat tjera të kompenzimit të dëmit, megjithëse nuk janë të njëjtë, pasi angazhimi në aktivitetet e bamirësisë ndodh zakonisht mbi baza vullnetare dhe jo mbi bazën e marrëdhënies së punësimit dhe ndryshe nga puna në dobi shoqërore, e cila synon të krijojë modelimin e një marrëdhënie punë, për të cilën mungon vetëm elementi i marrjes së pagës, angazhimi në aktivitete bamirësie synon të krijojë përgjegjësi civile dhe ndjenjën e empatisë, të keqardhjes, të ndihmës së ndërsjelltë dhe humanizmit.

Kur përzgjedhet kjo masë?

Prandaj si masë mund të jepet edhe në raste kur vepra e kryer ka pasur karakter dhe elemente të sjelljes antishoqërore të shoqëruar me mungesën e empatisë dhe humanizmit pavarësisht faktit të qënies së një veprë të lehtë penale.

¹¹ Udhëzimet e ofruara nga masat e diversitetit 1.9 deri 1.16 janë marrë si bazë nga 'Udhëzuesi mbi zbatimin e masave të diversitetit nga Shërbimi Sprovues i Kosovës' të përpiluar nga znj. Holta Zecaj eksperte ndërkombëtare. Ky 'Udhëzues' është publikuar nga UNICEF në Kosovë. Autori i këtij Moduli ka bërë disa modifike dhe ndryshime me qëllim të përshtatjes me qëllimet dhe nevojat e trajnimit për profesionistët e drejtësisë për të Mitur.

1.10. Pagesa e një shume të caktuar të të hollave të destinuara për qëllime bamirësie apo në programin për kompensim të viktimave në përputhje me situatën financiare të të miturit.

Çka synon kjo masë?

Kjo masë diversiteti synon të krijojë mekanizma kompensimi për dëmin e shkaktuar nga vepra penale e të miturit kryerës jo direkt për personin e dëmtuar apo për viktimën por për komunitetin apo grupin e viktimave të një kategorie të caktuar.

Ku dallon me masën tjetër 'kompensimi i dëmit'.

Tek masa 1.3. 'Kompensimi i dëmit...' kemi zhdëmtimin apo kompensimin e dëmit për të dëmtuarin dhe pasojën e shkaktuar atij apo asaj nga vepra penale në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ndërsa tek masa 1.10 kompensimi përmes pagesës bëhet duke paguar një shumë të hollash të cila destinohen për qëllime bamirësie apo në programin për kompensim të viktimave, pra kemi kompensim të palëve të treta për dëmin, dhe jo palës së dëmtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Kjo masë mund të shqiptohet edhe për veprat penale të shkaktuar ndaj individit si i dëmtuar i drejtëpërdrejtë, por me kusht që ky i fundit të pajtohet që për dëmin e shkaktuar atij apo asaj, shumën e të hollave të bëj për qëllime bamirësie apo në programin e kompensimit të viktimave të krimit.

Tjetër dallim është edhe tek elementi 'pagesës' pra nëse tek masa 'kompensimi i dëmit...' mund të ekzistojë mundësia që në vend të pagesës së shumës së të hollave të bëj kompensimin nëpërmjet 'punës zanatore apo ndonjë profesioni', tek kjo masë nuk ekziston mundësia që kryesi i mitur të bëj ndonjë kompensim apo 'punë zanatore' në vend të pagesës, pra këtu pagesa duhet të jetë vetëm në vlera monetare.

Rëndimi i gjendjes financiare të miturit!

Masa e shqiptuar duhet gjithnjë të bëhet në përputhje me gjendjen dhe situatën financiare të miturit. Pra, pagesa e cilësdo shumë të caktuar nuk duhet të kontribojë në rëndimin e gjendjes financiare të miturit, duke rezikuar jetën apo mirëqenien të miturit.

Ndikimi në ndërgjegjësimin dhe rritjen e përgjegjësisë.

Qëllimi i kësaj mase është të rrisë ndjenjën e përgjegjësisë ndaj dëmit që i vjen shoqërisë, komunitetit apo një grupi shoqëror të caktuar nga veprimi i të miturit. Gjithashtu kjo masë mund të përdoret në ato raste kur vetë i dëmtuari apo viktimia nuk ka arritur marrëveshje me të miturin kryerës siç do të ishte e nevojshme të ndodhte në kuadër të masës së diversitetit të pajtimit me viktimën dhe të kompensimit të viktimës.

1.11. Angazhimi në aktivitete sportive dhe rekreative.

Çka synon kjo masë?

Kjo masë diversiteti ka për qëllim të plotësojë dhe mbushë aktivitetin e përditshëm të të miturit me angazhime të shëndetshme sportive dhe argëtuese duke synuar të shmangë boshllëqet në angazhimin ditor të tij, çka mund të bëhet faktor për t'u përfshirë në kryerjen e veprës penale.

Ulja e sjelljeve negative dhe ngritja e përgjegjësisë.

Megjithëse në thelb kjo masë ka natyrë argëtuese dhe skeptikëve mund t'u duket sikur kësaj mase i mungon karakteri i një mase me natyrë detyruese të përshtatshme për t'u dhënë pas kryerjes së një vepre penale, në fakt kjo nuk është e vërtetë, sepse angazhimi për të kryer aktivitete sportive kërkon gjithashtu përgjegjëshmëri dhe vullnet, cilësi të cilat mund të kenë nevojë për t'u inkurajuar tek i mituri kryerës, gjithmonë kjo në varësi të kontekstit. Po kështu një nga qëllimet e drejtësisë restauruese është riparimi i marrëdhënies, modelimi pozitiv i sjelljes dhe mirëqënia e të miturit, të cilat shërbëhen mjaft mirë nga masa të tilla diversiteti.

1.12. Këshillimi ndërmjet familjeve të të miturve.

Përfshirja familjeve.

Kjo masë diversiteti ka një natyrë të veçantë pasi megjithëse detyron të miturin për ta zbatuar në thelb ajo përmban detyrime që dalin përtej mundësive individuale të vetë të miturit duke caktuar në fakt detyrime që lidhen me familjen e tij dhe eventualisht edhe me familjen e të miturit të dëmtuar/viktimë.

Më tepër se ndërmjetësim.

Në një kendvështrim të ngushtë kjo masë mund të përbënte më shumë një teknikë për të realizuar pajtimin se sa një masë të veçantë, moszbatimi i të cilës me sukses do të rëndonte mbi të miturin kryerës pavarësisht se zbatimi i saj nuk varet nga veprimet e tij. Megjithë këtë paradoks në dukje, kjo masë diversiteti synon të riparojë marrëdhënien e cënuar mes familjeve të të miturve të përfshirë në konflikt, e cila nëse nuk trajtohet mund të bëhet premisë për mospajtimin dhe ndoshta edhe për shkallëzimin e konfliktit më tej.

Përfshirja indirekte në vepër penale edhe të familjeve.

Kjo masë mund të jetë e nevojshme në rastet kur në konflikt janë përfshirë në mënyrë indirekte edhe anëtarë të tjerë të familjes, psh kur të miturit kanë përdorur sharje dhe fyerje kundrejt anëtarëve të familjes së njëri-tjetrit, nëse të miturit jetojnë shumë pranë njëri-tjetrit dhe pavarësisht masave të tjera të diversitetit siç është pajtimi me viktimën është e nevojshme që pajtimi dhe marrëdhëniet të trajtohen dhe të riparohen në bazë më të gjerë duke përfshirë edhe familjet e të miturve.

1.13. Të përmbahet nga çfarëdo kontakti me individë të caktuar që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri

Masë mbrojtëse dhe parandaluese?

Kjo masë diversiteti ka natyrën e një mase mbrojtëse dhe bazohet në premtimin e të miturit për të mos kryer një veprim. Kjo masë është e nevojshme të jepet ndaj të miturit, i cili rezulton të jetë i përfshirë në vepër penale për shkak të influencimit dhe modelit të gabuar apo negativ të një personi tjetër qoftë ky i mitur apo madhor.

Përcaktimi individëve në aktvendim të prokurorit.

Masa për të mos takuar individë të caktuar është e vështirë për t'u monitoruar dhe zbatimi i saj i suksesshëm varet kryesisht nga arritja e ndërgjegjesimit të miturit për efektet negative që ka kontakti me personin e përcaktuar në aktvendimin e masës së diversitetit.

1.14. Të mos vizitohet vende ose mjedise të caktuara që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri;

Mjediset negative.

Kjo masë diversiteti ka natyrën e një premtimi/zotimi dhe shërben si një masë mbrojtëse për të miturin për shkak të ndikimit negativ që sjellin aktivitetet që ndodhin në mjedise të caktuara apo për shkak të frekuentimit të këtyre mjediseve nga persona, të cilët mund të kenë efekt negativ tek i mituri.

Vendi i kryerjes së veprës penale si rethanë përcaktuese?

Kjo masë jepet bazuar në kontekstin e veprës penale të ndodhur apo edhe elementëve apo faktëve të tjerë, të cilat janë parashtruar apo janë pranuar nga i mituri në kuadër të pranimit të përgjegjësisë si kriter për dhënien e masës së diversitetit. Psh. kjo masë do të ishte e përshtatshme në rast se i mituri frekuenton vende ku shiten pije alkoolike, klube të cilat janë të njohura për frekuentimin nga njëri me histori penale, kinema të cilat janë filma me përmbajtje të papërshtme për të mitur, etj. Ashtu si është treguar më sipër edhe në rastin e masës për përmbajtje të kontaktimit të individëve të caktuar, sfida në zbatimin e kësaj mase është se ajo shpeshherë mund të merret përsipër lehtësisht nga i mituri duke menduar se monitorimi i zbatimit të saj është i vështirë pasi askush nuk do të bëjë rojen në vëndin e caktuar për të kapur të miturin në shkelje.

1.15. Të përmbahet nga përdorimi i drogës dhe i alkoolit.

Zotimi dhe premtimi?

Sikur edhe masët paraprake kjo masë e diversitetit për përmbajtje apo mospërdorim të drogës dhe alkoolit përbën në vetvete detyrimin për mbajtjen e një premtimi dhe zotimi se nuk do të përdorë drogë dhe alkool.

Kur shqiptohet kjo masë?

Kjo masa mund të jetë e përshtatshme për t'u shqiptuar në rastet kur i mituri ka kryer veprën penale nën efektin e konsumimit të alkoolit apo të drogës apo nëse vepra e penale ka ndodhur në kontekstin e

nevojës për të gjetur mjetet për të blerë alkool apo drogë, siç mund të jetë rasti i vjedhjes. Adresimi i çështjes së përdorimit të drogës apo alkoolit, e cila është bërë premisë apo ka përbërë motivimin kryesor të të miturit për t'u përfshirë në krim, është i nevojshëm dhe thelbësor për të realizuar qëllimin final të drejtësisë restauruese, dhënien e një shansi të dytë për riparimin e marrdhënies shoqërore të cënuar dhe realizimin e mirëqënies së të miturit.

Kombinimi i masave?

Masat 1.13; 1.14 dhe 1.15 për të qenë efikase dhe për të treguar rezultat afatgjatë do të duhej të kombinoheshin me masën e 'Këshillimit Psikologjik' kjo për faktin se zotimi dhe premtimi i të miturit për të mos iu afruar vendeve, individëve apo edhe përmbajtja nga përdorimi i alkoolit dhe drogës pa ndonjë mbështetje profesionale të psikologut do të ishte i zbehtë dhe mundësi të mëdha për të mos u zbatuar. Andaj ky, dhe shumë rastë të tjera e forcojnë mendimin që kombinimi i masave jo vetëm që është i lejuar, mirëpo ai ndikon shumë pozitivisht në trajtimin dhe risocializimin e tij apo saj.

1.16. Vërejtja policore.

Risia më e madhe?

Masa e diversitetit e vërejtjes policore është një nga rrisitë e ndryshimeve të fundit ligjore të KDM, e cila plotëson llojet e masave të diversitetit duke synuar evitimin e përballjes së panevojshme të së të miturve që kryejnë vepra të lehta për herë të parë.

KDM e ka veçuar këtë kategori të miturish duke dashur ta trajtojë me përparësi për shkak të përfshirjes së tyre shpeshherë aksidentale në vepra delinkuente. Masa e diversitetit e vërejtjes policore është e vetmja masë e cila jepet nga zyrtarët policorë pasi kjo masë është lejuar apo është miratuar paraprakisht nga prokurori.

Dallim nga të gjitha masat tjera?

Ndryshe nga masat e tjera të diversitetit, masa e diversitetit të vërejtjes policore jepet nga zyrtarët policorë me lejimin/miratimin e prokurorit. Ky mekanizëm ligjor i posaçëm është parashikuar nga ligjdhënësi me qëllim shmangien sa më shumë dhe sa më herët në kohë të përballjes së të miturit kryerës me sistemin e drejtësisë formale.

Ky mekanizëm duke qenë se përbën risi, është e rëndësishme të kuptohet si në aspektin procedural dhe atë të hapave të nevojshme që rekomandohen të merren me qëllim zbatimin efektiv të masës duke garantuar të drejtat procedurale të të miturve si dhe duke respektuar mandatet ligjore të institucioneve të përfshira, atë të policisë dhe të prokurorisë. Në këtë kuadër dhënia e diskrecionit zyrtarëve policorë për dhënien e masës së diversitetit të vërejtjes policore është shoqëruar jo pa qëllim me mbikqyrjen e kësaj mase nga ana e prokurisë, i cili është institucioni i mandatuar me ligj për të realizuar procedimin penal.

Për cilat vepra mund të caktohet kjo masë?


Kjo masë diversiteti është një masë, e cila jepet kryesisht për vepra të lehta dhe synon të krijojë ndërgjegjësim dhe më shumë përgjegjshmëri tek i mituri në lidhje me veprën penale të kryer nga ai si edhe për pasojat që vijnë nëse ai përfshihet në një vepër penale tjetër në të ardhmen, çka do të bënte që edhe vetë masa e diversitetit të binte e të rifillonte procedura penale. Pra, duhet të plotësohet dy kushte në mënyrë kumulative, vepra me qenë e lehtë dhe jetë e kryer për herë të parë.

13. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Shqiptimi, dhe më pastaj edhe ekzekutimi i masave të diversitetit përbën një sfidë jo edhe të vogël, e cila kërkon vëmendje dhe një planifikim shumë profesional dhe të organizuar nga të gjitha institucionet dhe profesionistët e përfshirë.

Këto institucione dhe profesionistë të përfshirë për të realizuar me lehtësi dhe në mënyrë të duhur ekzekutimin, duhet të bashkëpunojnë për të koordinuar zbatimin e programeve që kërkohet për secilën masë veq e veq.

Vetë llojllojshmëria dhe numri shumë i madh i masave të diversitetit kërkon përfshirjen dhe bashkëpunimin ndërmjet shumë institucioneve dhe jo vetëm, sepse këtu role dhe përgjegjësi kanë edhe prindërit edhe komuniteti dhe shoqëria ku jetojnë dhe ndërveprojnë të miturit.



Pa marrë parasysh rolin dhe përgjegjësinë e secilit të përfshirë në rast, i mituri gjithnjë duhet të jetë në qendër të çdo planifikimi apo intervenimi që ndërmarrim për të mbrojtë dhe trajtuar atë të mitur.

Për të realizuar qëllimin e masave të diversitetit kërkohet bashkëpunimi dhe ndërveprimi nga këto institucione dhe mekanizma por jo vetëm:

- Shkolla;
- Qendra për Punë Sociale;
- Shëndetësia;
- Policia;
- Prokuroria;
- Gjykata;
- Shërbimi Sprovues;
- Avokati;
- OJQ-të;
- Mediat
- Insitucionet ku ekzekutohet masa (Shërbimet Psikologjike-Qendrat e Shëndetit Mendor; Qendrat për Aftësim Profesional; Autoshkollat; Bibliotekat; Kryqi i Kuq dhe organizat tjera humanitare; Komunitetet Fetare; Spitalet Publike dhe Private; Klubet Sportive; Ndërmarrjet Publike; Bizneset e ndryshme private etj).

Të gjitha këto institucione dhe mekanizma nëpërmjet bashkëpunimit dhe ndërveprimit duhet të sigurojnë programe dhe aktivitete që ndikojnë në trajtimin, risocializimin dhe reintegrimin e të miturit që ka kryer vepër penale. Programet janë të ndryshme dhe të shumta, por të miturit në minimum duhet ti sigurohet ato që derivojnë nga vet lloji i masës së shqiptuar e që përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në këto:

- Shërbimet e ndërmjetësimit;
- Pjesmarrja në programet për mos braktisjen e shkollës;
- Ngritja e aftësive dhe shkathtësive për jetën;
- Aktivitete sportive dhe rekreative;
- Edukimi në rregullat e trafikimit;
- Këshillim psikologjik;
- Pjesmarrja aktive në programe vullnetarizimi;
- Trajtim për parandalim të varësisë prej alkoolit dhe drogave;
- Programet e kujdesit në komunitet;
- Shërbimet e specializuara etj.

14. PËRPARËSITË DHE DOBITË

Shqiptimi dhe ekzekutimi me sukses i masave të diversitetit ka shumë përparësi dhe dobi jo vetëm për të miturit, por edhe për familjen, komunitetin dhe vet sistemin e drejtësisë në përgjithësi.

Përfitimet e të miturve

- Parandalimi që të miturit të vuajnë nga ndikimi negativ zhvillimor i lidhur me procedurat gjyqësore formale, duke përfshirë stigmatizimin e fëmijës (dhe familjes së tyre) dhe nga evidence penale;
- Parandalon ndikimin negativ dhe afatgjatë të burgimit në zhvillimin e shëndetit fizik, mendor dhe emocional të të miturit, si dhe rritjes së mundësisë për të përsëritur veprat penale që vijnë si pasojë e privimit nga liria;
- Sigurohen për shpejtësinë dhe bartjen e pasojave nga sjellja dhe kryerja e vepres penale;
- Synohet zbulimi i arsyeve që janë ndikuar në sjelljen e kryesit të mitur për të kryer atë veprë penale si dhe identifikimi dhe adresimi i nevojave të fëmijës si dhe ofrimi i aktiviteteve efektive rehabilituese;
- Kontribuojnë pozitivisht në zhvillimin e të miturit;
- E përfshin fëmijën dhe mundëson me i kuptu pasojat e veprës së kryer;
- Inkurajon fëmijën në marrjen e përgjegjësive për dëmin e shkaktuar, në atë mënyrë që e rehabiliton dhe reintebron atë në shoqëri, me theks të veçantë nëse shmangia është e kombinuar sipas qasjes së drejtësisë restauruese.

Përfitimet e shoqërisë

- Zvoglohet mundësia për recidivizëm;
- Evitohen kostot e larta nga procedimi i rastit nëpërjet sistemit formal të drejtësisë;
- Evitohen kostot e larta nga mbajtja në paraburgim të të miturve;
- Riparohet dëmi i shkaktuar nëse shmangia kombinohet me qasjen e drejtësisë restorative;
- Kontribon në zhvillimin social dhe zhgjidhjen e konfliktit;
- Ndikon dhe kontribon në përpjekjet për ndërtimin e paqes dhe vendosjes së nevojave të viktimës në qendrës të procesit nëse shmangia kombinohet me qasjen e drejtësisë restorative;
- Kontribon pozitivisht në përmirësimin e sigurisë kombëtare duke promovuar përfshirjen se sa përjashtimin e të miturve që janë të cenueshëm.

Përfitimet e sistemit

- Zvoglohet numri i të miturve dhe veprave të lehta të cilat e ngulfasin sistemin gjyqësor formal, si dhe lejojnë që resurset të fokusohen tek recidivistët dhe kryesit që janë me rrezikshmëri të lartë;
- Zvoglon numrin e të miturve që privohen nga liria, e cila mund të ndikojë në përmirësimin e kushteve të atyre të miturve që tashmë janë privuar nga liria;
- Ju mundëson zyrtarëve të sektorit të drejtësisë për tu marrë me rastin në mënyrë ekspeditive;
- Rritë profesionalizmin, knaqësinë në punë dhe moralin e personelit që punon në sektorin e drejtësisë për të mitur.

15. ANEKSE

A) Terme dhe përkufizime nga KDM

Fëmijë - personi i cili nuk e ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet;

I mitur – personi i cili ka mbushur katëmbëdhjetë (14) vjet por nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet;

I mitur i ri - personin i cili ka mbushur katëmbëdhjetë (14) vjet, por nuk i ka mbushur gjashtëmbëdhjetë (16) vjet;

I mitur i rritur – personi i cili ka mbushur gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, por nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet;

Madhor i ri – personi i cili ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet, por nuk i ka mbushur njëzetën (21) vjet;

Madhor - personi i cili ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet;

Edukim i specializuar - programi edukativ i përpiluar sipas nevojave speciale të kryerësit të veprës penale, i cili synon të ndihmojë zhvillimin e gjithmbarshëm adekuat të tij dhe të zvogëlojë mundësinë e recidivizmit;

Burgim për të mitur – dënimi me burgim i shqiptuar ndaj kryerësit të mitur ose ndaj madhorit, në pajtim me Pjesën e Dytë Kapitulli VII të këtij Kodi;

Objekt për kujdes të posaçëm shëndetësor – institucioni i cili siguron trajtim kryerësit të mitur me çrregullime mendore;

Organ i kujdestarisë – organi përgjegjës që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale i cili është përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve;

Gjyqtari për të mitur - gjyqtari i cili është ekspert në çështjet penale ku është përfshirë i mituri, fëmiu dhe madhor i ri, i cili është kompetent për ushtrimin e përgjegjësive në këtë Kod. Gjyqtari për të mitur është i caktuar në fazën e procedurës përgaditore dhe si kryetar i trupit dhe i kolegjit në të gjitha fazat e procedurës penale;

Prokuror i shtetit për të mitur – prokuror i shtetit i cili është ekspert në çështjet penale ku është i përfshirë i mituri, fëmiu dhe madhori i ri, ndjekjen e kryerësve madhorë për veprat e kryera ndaj të miturve dhe i cili është kompetent për ushtrimin e përgjegjësive të parapara në këtë Kod;

Trupi gjykues për të mitur - trupi i përbërë prej tre (3) gjyqtarëve prej të cilëve kryetari është gjyqtar për të mitur i cili gjykon gjatë shqyrtimit gjyqësor;

Kolegji për të mitur - kolegji i përbërë prej tre (3) gjyqtarëve prej të cilëve kryetari është gjyqtar për të mitur i cili merr vendime në seancë jashtë shqyrtimit gjyqësor;

Ndërmjetësuesi – personi i tretë neutral i cili ndihmon viktimën dhe kryesin e veprës penale që nëpërmjet komunikimit t'i ndihmojë palët të arrijnë zgjidhje të përshtatshme lidhur me mosmarrëveshjen;

Fëmijë viktimë apo dëshmitar – personi nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet i cili është viktimë apo dëshmitar i veprës penale;

Fëmijë nën moshën e përgjegjësisë penale – fëmiju i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur katëmbëdhjetë (14) vjet;

Mbrojtësi i viktimave - përfaqësuesi i autorizuar për mbrojtjen e interesave të fëmijëve viktimë;
Mbrojtësi i të miturit - mbrojtësi i licencuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës;

Privimi nga liria – çdo formë e paraburgimit apo burgimit apo vënie e personit në ambient të arrestit apo ndalimit policor, e të cilin ky person nuk mund ta lëshojë sipas vullnetit të vet, sipas vendimit të ndonjë autoriteti gjyqësor, administrativ apo autoritet tjetër publik;

Riviktimizimi - situatë, në të cilën një person vuan më shumë sesa një incident penal për një periudhë të caktuar kohe.

Profesionist i drejtësisë për të mitur – nënkupton të gjithë profesionistët që punojnë dhe mirren me trajtimin e të miturve, dhe përfshin këta profesionistë por jo vetëm: Policin, Avokatin, Prokurorin për të Mitur, Gjyqtarin për të Mitur, Zyrtarin e Shërbimit Sprovues, Punëtorin Social etj.

Drejtësia restauruese - është një qasje e drejtësisë e orjentuar në riparimin –sa më shumë të jetë e mundur-e dëmit të shkaktuar nga një krim apo konflikt

RAST STUDIMI (A)

E pandehura

B.B, sapo ka mbushur 16 vjet, dhe është arrestuar për dëmtim të pronës. Ajo ka vepra të mëhershme, duke përfshirë mungesa të paarsyeshme në shkollë (3 raste) dhe dy herë e arrestuar për vepra të tjera të lehta. Para një muaji, ajo është vërejtur duke gjuajtur gurë në një automjet Volksëagen, i cili ishte parkuar në rrugën Ali Hadri nr.5. në Prishtinë. Dëshmitar ishte B.D, i cili jeton afër kësaj adrese. Pasi është konfrontuar nga dëshmitari, i cili e thirri policinë, e mitura iku. E mitura është arrestuar nga policët disa blloqe larg vendit të ngjarjes dhe është identifikuar nga dëshmitari. E mitura pranoi hedhjen e gurëve. Dëmi është shkaktuar në xhamin e pasëm të veturës dhe dritaren e pasme të pasagjerit. Të dyja janë thyer. Gjithashtu është dëmtuar ngjyra në panelin e pasëm të majtë dhe në bagazh. Dëmi i përgjithshëm llogaritet në 900 EURO.

I dëmtuari

Është qytetari H.H, 48 vjeçar, i pamartuar. Shtëpia ku makina është dëmtuar është shtëpia e tij, të cilën e kishte dhënë me qera për njerëzit tjerë për 4 vjet. I dëmtuari që disa vite ishte duke jetuar me prindërit në shtëpinë e këtyre të fundit.

Për rastin e dëmtimit të makinës së tij, i dëmtuari njoftohet nga dëshmitari dhe policia e cila kishte arrestuar të miturën. Në ato caste i dëmtuari nervozohet tepër nga ky lajm, dhe dëshiron të ndërmer veprime hakmarrëse, mirëpo dëshmitari dhe komshiu e ndalojnë që të ndërmer ndonjë veprim.

Policia pëpilon kallzim penal dhe të njëjtin e dorëzon në Prokurori. Prokurori i Shtetit për të Mitur konform dispozitave të KDM, nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve dhe në të njëjtën kohë kërkon nga Shërbimi Sprovues i Kosovës hartimin e anketës sociale për të miturën.

Në bazë të anketës sociale, shihet që e mitura kishte pranuar veprën penale dhe kishte treguar pendesë të sinqertë. Poashtu ajo kishte probleme dhe ngecje në aspektin edukativ dhe arsimor. Për më tepër, ajo kishte edhe disa vepra të imta penale të kryera në të kaluarën e saj.

Shërbimi Sprovues në anketën sociale i rekomandon prokurorit mundësinë e shqiptimit të ndonjërës prej masave të diversitetit apo referimin e rastit në ndërmjetësim.

Ju lutem ti përshkruani veprimet konkrete që duhet ti ndërmerrni, me theks të veçantë:

- A do të zgjedhni procedurën e ndërmjetësimit apo do të shqiptoni masën e diversitetit?
- Nëse do të vendosni për shqiptimin e masës së diversitetit, cilën apo cilat masa do ti përzgjedhni?
- Apo, do të procedoni me propozim për shqiptimin e masave edukative apo dënimin ndaj të miturës?

RAST STUDIMI (B)

Drini kapet në flagrancë!

Drini sapo ka mbushur 14 vjeç. Nëna e tij e kishtë porositur për të shkuar në minimarketin e lagjes për të blerë ca gjëra për nevoja të shtëpisë. Me të dalë nga minimarketi ai është kapur nga roja e minimarketit për shkak që një pjesë të produkteve nuk i kishte paguar. Produktet e papaguara ishin 2 parfume të cilat kishin vlerën prej 90 euro.

Roja i minimarketit e njofton menaxherin dhe diskutojnë për rastin. Ata vendosin që të njoftojnë policinë dhe familjen e Drinit.

Pas 30 minutave vie nëna e Drinit dhe Policia. Fillimisht menaxheri i rastit diskuton me nënën e Drinit dhe më pastaj i tregon Policisë për rastin.

Hera e parë në konflikt me ligjin!

Drini tërë kohën ndihej i mërzhitur dhe shumë i shqetsuar. Në bazë të informatave të ofruara nga nëna, Drini është një djalë i edukuar, sjellshëm dhe me respekt të madh për prindërit dhe komunitetin ku jeton. I vetmi shqetësim i Nënës së Drinit, është se ai tanimë ka filluar të shfaqë disa simptoma që ndërlidhen me qëndrimin vonë natën, dhe vonesat e kohë pas kohshme në shkollë.

Pas intervistimit nga Policia, Drini sqaron se ai këto parfume 'i ka vjedhur' për shkak që i vinte turp ti kërkonte para prindërve për ti blerë këto parfume, dhe nuk dëshironte të zbulohej nga prindërit që ai qe disa muaj kishte filluar të takohej me një bashkëmoshatare të cilën e kishte simpati. Këta të dy janë nga e njëjta shkollë dhe lagje.

Ai shpesh shumë keqardhje dhe është i penduar për veprimin e tij, duke u betuar që nuk do ta përsëris në të ardhmen këtë veprim. Për më tepër Nëna e Drinit kërkon falje dhe i paguan minimarketit të dy parfumet e vjedhura nga Drini.

Çka më tutje!

Në ndërkohë pas intervistimit, Policia e thëret Prokurorin e Shtetit për të Mitur dhe kërkon udhëzime se çka të ndërmarrin në rastin konkret?

Ju lutem ti përshkruani veprimet konkrete që duhet ti ndërmerrni, me theks të veçantë:

- A do të caktonit masën e diversitetit 'vërejtja policore'?
- Nëse nuk do të caktoni vërejtjen policore cilën masë tjetër do të shqiptonit?
- Nëse asnjërën si më lart, çka do të ndërmirnit në rastin konkret.

C) Forma të vendimeve

C-1) MOS FILLIMI I PROCEDURËS PËRGADITORE (PARIMI I OPORTUNITETIT)



**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

Prokuroria Themelore në/ Osnovno Tužilaštvo u/ Basic Prosecutor's Office in

DEPARTAMENTI PER TE MITUR

PPM. nr. 75 / 20.....

Datë 13.05.....

Në bazë të nenit 52 par. 2. të Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM), merr këtë;

AKTVENDIM

PËR MOS FILLIMIN E PROCEDURËS PËRGADITORE

Ndaj të miturës:

1., nga fsh. ... ,K e, e lindur më 12.06.1997, nxenese, nuk zhvillohet procedure tjetër penale, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës,

A r s y e t i m

Ndaj të miturës, nga fsh. , K e është ushtruar kallëzimi penal me nr., për shkak të dyshimit të bazuar se më dt. 16.04.20..., ka kryer veprën penale **vjedhje, nga neni 313 te KPRK.**

Nga shkresat e lëndës të cilat gjenden në kallëzimin penal, nga deklarata e të miturës të dhënë në polici, kemi ardhur në përfundim se e mitura me dt. 16.04.20....., ka kryer veprën penale vjedhje, nga neni 325 paragrafi 2 te KPRK., por deklaron se ndihet shume e penduar per rastin nuk do te përsërisë me vepër penale, i ka kërkuar falje te dëmtuarës, është hera e pare qe ka ra ndesh me ligjin.

Prokurori i shtetit, duke u mbështetur në nenin 52 parag.2.të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, për shkak të natyrës së veprës penale, rrethanave në të cilën është kryer ajo, zotimit se më nuk do të kryej vepër tjetër penale, si dhe e mitura për Prokurorinë nuk është e njohur më parë si kryre e veprave penale, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktvendimi i dorëzohet:

Qendrës për pune Sociale,

PROKURORI I SHETIT,

X.X.



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Themelore në/ Osnovno Tužilaštvo u/ Basic Prosecutor's Office in

Numri i lëndës: 2022:.....

Datë: 27.09.20.....

Numri i dokumentit:

PPM.nr...../20.....

Konform nenit 52, para .2 e 4, të KDM-së marrë:

A K T V E N D I M

PER

MOS FILLIMIN E PROCEDURES PERGADITORE

Ndaj të miturve:

1. **F.F**, nga babai F., i lindur më 04 Shkurt 20....., në, me vendbanim në, në rrugën "Mulla Idrizi", objekti banesor "A.....", kati V, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ngase procedura përgatitore nuk kishte me ju përshtatur qëllimit të vetë.
2. **E.N**, nga babai I. dhe nëna M, e gjinisë K, i lindur më 30 Korrik 20....., në, ku edhe jeton në lagjen "Dh.B" "Xh", nxënës, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ngase procedura përgatitore nuk kishte me ju përshtatur qëllimit të vetë.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në – Departamenti për të Mitur, me datë 13 Shtator 2022, kësaj prokurorie i ka dorëzuar në kompetencë kallëzimin penal të parashtruar nga Policia e Kosovës – Stacioni Policor Jugu në Prishtinë, me numër të rastit, ndaj të miturve F.F dhe E.N, nga, për shkak të dyshimit se në bashkëveprim kanë kryer veprën penale, asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, nga nenin 321 të KPRK-së.

Pas shqyrtimit të të dhënave në kallëzimin penal, si dhe provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, siç janë: raporti fillestar i incidentit, me numër të rastit, i datës 08 Gusht 20....., deklarata e të dëmtuarit D.G, deklarata e të miturve F.F, E.N, deklarata e T.M, për të cilin është ngrit kallëzim penal dhe procedura është zhvilluar në Prishtinë si vend i kryerjes së veprës penale, pastaj vërtetimi mbi marrjen dhe kthimin e sendeve, raporti i oficerit, kopjet e letërnjoftimit, konsiderojmë se ekziston dyshimi i arsyeshëm se të miturit e lartcekur me datë 08 Gusht 20....., në bashkë veprim kanë kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Aktvendimi që të mos fillohet procedura përgatitore ndaj të miturve F.M dhe E.N, nga, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, është bazuar edhe në parimet udhëzuese të KDM-së, ku mirëqenia e të miturit është faktor përcaktues së bashku me rrethanat e kryerësit dhe veprën penale, si dhe në nenin 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës ku në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese, ndërsa në rastin konkret mos procedimi i lëndës me tutje dhe mos ballafaqimi i të miturve me procedurat në institucionet e tjera të drejtësisë siç janë gjykata dhe prokuroria, janë në interesin më të lartë të të miturit.

Andaj, nga këto që u tha më lartë, si dhe duke u mbështetur në nenin 52 paragrafi 2 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, për shkak të natyrës së veprave penale, rrethanave në të cilën janë kryer ato, dëmtit të vogël, pendimi i të miturve, premtimi se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra penale, po ashtu bllokada është kthyer tek i dëmtuari, si dhe të miturit për Prokurorinë nuk janë të njohur më parë si kryerës të veprave penale, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

PROKURORI SHETËTIT

Y.Y

Vendimi ti dorëzohet:

- 1.Një kopje e këtij aktvendimi t'i dorëzohet ushtruesit të kallëzimit penal.**
- 2.Një kopje e këtij aktvendimi të mbetet në shkresat e kësaj lënde.**
- 3.Një kopje e vendimit të miturve.**



**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

Prokuroria Themelore në / Osnovno Tužilaštvo u / Basic Prosecutor's Office in

Departamenti për te mitur

PPM.nr./20....

Datë: 15.11.20.....

Në bazë të neneve 19, 20 dhe 21 para. 1,1, si dhe nenit 49 dhe 74 të KDM-së me dt, nxjerrë këtë:

A K T V E N D I M

Ndaj të miturit:

D.D nga babai M. dhe nena M, e gjinisë E i lindur më datë 13.12.20..., në GJ, me vendbanim në rrugën "M...T...." nxënës në shkollës së mesme "M.M", klasa XI shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. tel

**Pezullohet ndjekja penal dhe të njëjtit
I SHQIPTOHET MASA E DIVERSITETIT –
- Pajtimi ndërmjet te miturit dhe palës se dëmtuar -
(A.A me nr. tel.),**

Këtë masë do ta ekzekutoj Shërbimi Sprovues – Zyra regjionale në.... , në pajtim me dispozitat e KDM-së, ndërkaq në pajtim me nenin 74 parag.,2, kjo prokurori do të mbikëqyrë ekzekutimin e kësaj mase të diverzitetit, në rast të mos kryerjes së detyrimeve që rrjedhin nga aktvendimi ndaj të miturit mund të vendoset për rifillimin e ndjekjes penale.

Shpenzimet e procedurës përkitazi me zbatimin e kësaj mase bien në ngarkesë të buxhetit të Republikës së Kosovës

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës

Prokuroria Themelore në – Departamenti për të mitur, me datë 05.10.20..., ka pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga Stacioni policor në....., me nr. të rastittë datës 02.10.20....., ndaj të miturit te lartpërmendur, për shkak të veprës penale, vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 të Kodit penal të Republikës së Kosovës.

Kjo prokurori pasi ka shqyrtuar të dhënat nga kallëzimi penal dhe shkresat e tjera të cilat i janë bashkangjitur të njëjtit, ka nxjerre aktvendim për fillimin e procedurës përgatitore, ka njoftuar QPS-se, nga SHSK-ja, ka kërkuar anketën e plote sociale.

I mituri D.D në deklaratën e dhënë në polici në prezencë të avokatit mbrojtës ka deklaruar se me datën 22.09.20.... kam shkuar mbrapa FSK-ës për ti marrë drunjtë, në tokë kam parë disa shtrafa- vida me mbajtëset e tyre ku ishin rreth 35 copë të cilat kanë shërbyer për mbajtjen e shtyllave të liftit të cilat i kam marrë me qëllim që ti shesë për të cilat kam menduar se janë të panevojshme të cilat ja kam kthyer të dëmtuarit.

I dëmtuari A.B në deklaratën e dhënë në polici me datë 23.09.20..... , ka deklaruar se në ditën kritike gjatë inspektimit kam vërejtur se mungonin një paketë me bulona për montimin e liftit dhe dy pjesë të llamarinës që shërbejnë për ndërtim të liftit e që vlera e tyre është rreth 50€.

Për të miturin nga shërbimi sprovues zyra regjionale ne, kemi pranuar me shenjen AS.nr.....-.....e dt. 23.10.20...., nga e cila ankete shihet se te mituri për here te dytë ka ra ne kundërshtim me normat ligjore, ka te kryer shkollën fillore, vijon mësimin ne shkollën e mesme, niveli i shkollimit te familjes është i mesme, e mituri e pranon se ka kryer veprën penale dhe thotë se e ka bërë pa qëllim.

Gjetjet e prokurorit;

Nga ajo që u theksua më lartë është konstatuar se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 19 që të arrihet qëllimi i masave të diversitetit, ndërsa po ashtu janë plotësuar kushtet për shqiptimin e masave të diversitetit nga neni 21 para. 1.1 dhe 1.4 të KDM-së, që ndaj të miturit në fjalë në bazë të nenit 20 para.1, nënpara. 1,1, të KDM-ës, shqiptohet Masa e Diversitetit- Pajtimi në mes kryesit të mitur dhe palës së dëmtuar , duke përfshirë kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar – si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Andaj në pajtim me nenin 49 të KDM-së, nuk është vazhduar me ndjekje penale ndaj këtij të mituri për veprën penale të sipërshënuar, për arsyet e lartpërmendura, veçanërisht duke mare parasysh, pranimin e përgjegjësisë për veprën penale, për të cilën thotë se e ka bërë pa qëllim, andaj konsiderojmë se një masë e këtillë është në interesin më të mirë të miturit dhe me këtë masë do të arrihet efekti i duhur në parandalimin e sjelljeve recidiviste tek i njëjti.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi është lejuar ANKESA në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Prokurorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

Shërbimit Sprovues në.....,
Gjykatës Themelore në

PROKURORI I SHTETIT

Y.Y



**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

Prokuroria Themelore në/ Osnovno Tužilaštvo u/ Basic Prosecutor's Office in

DEPARTAMENTI PËR TË MITUR

PPM.nr./20....

Datë: 15.06.20....

.....

Në bazë të nenit 19, 20 dhe 21 para. 1,1, si dhe nenit 49 dhe 74 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM-së) nxjerr këtë :

A K T V E N D I M

Ndaj të miturve:

1.A.A, i lindur më dt. 07.06.20.... në, jeton në rrugën: „Adem Jashari” -, nxënës i shkollës fillore „B.B” kl.V/5, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.T.A, i lindur më dt. 06.08.20.... në, jeton në rrugën: „Adem Jashari” -, nxënës i shkollës fillore „B.B” kl.IX/5, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

PEZULLOHET

ndjekja penale dhe të njëjtëve

- U SHQIPTOHET MASA E DIVERSITETIT –

Pajtimi në mes kryerësve të mitur – dhe palës së dëmtuar A.H, nga, rr.”V.I” p.n (Lagjja- afër varrezave), duke përfshirë kërkim faljen nga të miturit ndaj palës së dëmtuar.

Këtë masë do ta ekzekutoj Shërbimi Sprovues – Zyra Regjionale në....., në pajtim me dispozitat e KDM-së, ndërkaq në pajtim me nenin 74 kjo prokurori do të mbikëqyr ekzekutimin e kësaj mase të diversitetit, në rast të moskryerjes së detyrimeve që rrjedhin nga Aktvendimi ndaj të miturit mund të vendoset për rifillimin e ndjekjes penale.

Shpenzimet e procedurës përkitazi me zbatimin e kësaj mase bien në ngarkesë të buxhetit të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m :

Me datën 25.05.20..... kësaj Prokurorie i është dorëzuar kallëzimi penal nga stacioni policor – në, me nr. të rastit i datës 21.05.20.... ndaj të miturve të lartpërmendur, për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 para.1 nën paragrafi 1.1 dhe neni 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)

Kjo Prokurori pasi ka shqyrtuar të dhënat në kallëzimin penal dhe shkresa të tjera që i janë bashkangjitur të njëjtit, ka marrë në pyetje të miturit A.A dhe T.A në prezencë të përfaqësuesit ligjor-prindit të tyre dhe avokatëve mbrojtës sipas detyrës zyrtare, të miturit kanë deklaruar se e pranojnë kryerjen e kësaj veprave penale, pendohen për veprën e bërë, premtojnë se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tjera penale si dhe pajtohen me shqiptimin e masës së diversitetit, me këtë masë pajtohet edhe përfaqësuesi i tij ligjor prindi si dhe mbrojtësit sipas detyrës zyrtare.

Anketa sociale e të miturve me shenjat: As.Nr....., e datës 07.06.20....., deklarata e të dëmtuarit e dhënë në stacionin policor më datë 18.05.20....., deklarata e të miture, deklarata e dëshmitarit, foto dokumentacioni, janë prova tjera materiale të cilat e dokumentojnë ekzistimin e veprës penale të lartë cekur dhe rrethanat personale të të miturit.

Nga ajo që u theksua më lartë, është konstatuar se në rastin konkret janë plotësuar: qëllimi i masave të diversitetit dhe kushtet ligjore të përcaktuara në **KDM** në nenet 9, 20, 21 për shqiptimin e masës së diversitetit si në dispozitiv të këtij aktvendimi si dhe kërkesat e Konventës për të Drejtat e Fëmijës (**KDF**) neni 3 paragrafi 1 dhe neni 40 paragrafi 3 pika b: ku interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese dhe se parandalimi i fillimi i procedurës gjyqësore ndaj kryesit të mitur dhe se nuk është vazhduar me ndjekje penale.

Andaj, konsiderojmë se një masë e këtillë është në interesin më të mirë të të miturve dhe do të arrihet efekti i duhur rehabilitimin pozitiv me qëllim të parandalimit të sjelljeve recidiviste.

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Prokurorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

Gjykatës Themelore në- Departamentit për të Mitur;
Shërbimit Sprovues në;
Të dëmtuarit;
Të miturit.

PROKURORI PËR TË MITUR

X.X.

C-5) SHQIPTIMI I MASËS SË DIVERSITETIT-VËREJTJA POLICORE



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Themelore në / Osnovno Tužilaštvo u / Basic Prosecutor's Office in

Numri i lëndës: 2020:.....

Datë: 18.02.20.....

Numri i dokumentit:

Departamenti për të mitur

PPN. M.nr..../20.....

Date; 18.02.20.....

POLICISË SË KOSOVËS
Stacionit të policisë-Njësisë së hetimeve

.....

Lënda: Përgjigje në raportin e veçantë, të pranuar në këtë Prokurori më dt. 11.02.20...., për rastin nr. CA-2....., të dt. 06.02.20....., të paraqitur nga Policia e Kosovës- NJHK- Stacioni Policor në, për shkak të veprës penale, mbajtja në pronësi-kontrollë të armëve-një brisku, nga neni 366 të KPRK-së,

E vlerësojmë si mjaft të arsyeshëm raportin tuaj lidhur me rastin konkret dhe se i njëjti (raporti juaj) është në harmoni të plotë me ne nenin 81 para. 4 të KPP-së.

Pas shqyrtimit të gjithanshëm dhe të plotë të raportit të juaja të lartpërmendura dhe shkresave tjera që të njëjtit i janë bashkangjitur, vërejmë se në këtë rast kryesi i kësaj vepre penale është: B.N, i lindur 11.10.20....., në, me vendbanim në fsh. B.... , me nr tel, në shkollë ka mbajtur me vete një brisk ngjyrë e zezë-e kuqe, në shkelje të ligjit të zbatueshëm lidhur me armët.


- I mituri është intervistuar ne prezencën e prindit, pastaj
- nuk kemi dëm të shkaktuar për palën e tretë ,
- i mituri ka pranuar përgjegjësin penale,
- i mituri është për herë të parë në procedurë,
- i mituri është i moshës 15- vj.

Andaj,

KONSTATOJMME se me këtë rast plotësohen kushtet për shqiptimin e Masës së diverzitetit VEREJTJA POLICORE e parapare në nenin 19 e 20 para.1 nën para 1.16 të KDM-es, për të miturin, B.N nga fshK.....

Prokuror i Shtetit
Y.Y

Për arsyet e lartshënuara, NJHK në, udhëzojm që të miturit t'i shqiptoj vërejtjen policore,



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor



Prokuroria Themelore në / Osnovno Tužilaštvo u / Basic Prosecutor's Office In.....

Departamenti për të mitur

PPN. M.nr...../20.....

Date; 18.02.20.....

.....

SHENIM ZYRTAR

Pas shqyrtimit të gjithanshëm dhe të plotë të raporteve të juaja të lartpërmendura dhe shkresave tjera që të njëjtit i janë bashkangjitur, vërejmë se në këtë rast kryesi i kësaj vepre penale: B.N, i lindur 11.10.20....., në, me vendbanim në fsh. B..... K..., me nr. tel, në shkollë ka mbajtur me vete një brisk ngjyrë e zezë-e kuqe, në shkelje të ligjit të zbatueshëm lidhur me armët.

- I mituri është intervistuar në prezencën e prindit, pastaj
- nuk kemi dëm të shkaktuar për palën e tretë ,
- i mituri ka pranuar përgjegjësin penale,
- i mituri është për herë të parë në procedurë,
- i mituri është i moshës 15- vj.

Andaj,

KONSTATOJME se me këtë rast plotësohen kushtet për shqiptimin e Masës së diverzitetit VEREJTJA POLICORE e parapare në nenin 19 e 20 para.1 nën para 1.16 të KDM-es, për të miturin, me q' rast i udhëzpjme policinë që ta shqiptojnë të njëjtën, të miturit B.N nga fsh B..... K.....

Prokuror i Shtetit
Y.Y

D) Burimet dhe materialet e konsultuara

- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve e vitit 1989¹⁴;
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur (KODI Nr. 06/L-006) GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 17 / 18 TETOR 2018, PRISHTINË.
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KODI NR. 06/L-074) GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 2 / 14 JANAR 2019, PRISHTINË
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës (KODI NR. 08/L-032) GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 24 / 17 GUSHT 2022, PRISHTINË
- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (LIGJI NR. 06/L-084) GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 14 / 17 KORRIK 2019, PRISHTINË
- Rregullat dhe udhëzuesit e Pekinit¹⁵,
- Rregullat dhe udhëzuesit e Tokyos¹⁶,
- Rregullat dhe udhëzuesit e Riadit¹⁷,
- Udhëzimet e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi "Qasjen e Kombeve të Bashkuara rreth Drejtësisë për të Mitur" të vitit 2008¹⁸;
- Udhëzuesit e Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë ku përfshihen fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë të vitit 2005¹⁹;
- Udhëzuesit e Këshillit të Evropës mbi Drejtësinë Mike për Fëmijë të vitit 2010²⁰;
- Komentari numër dhjetë i Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve në Drejtësinë për të Mitur²¹;
- Five Advocacy Briefs on Child Justice. Diversion of Children in Conflict with the Law from Formal Judicial Proceedings in Europe and Central Asia. UNICEF Regional Office for Europe and Central Asia. November 2022;
- Acqui Communitarie, veçanërisht me direktivat e fundit që janë nxjerrë pikërisht mbi mbrojtjen e fëmijëve gjatë proceseve ligjore²².

¹⁴ <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CRC.aspx>

¹⁵ <http://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/beijingrules.pdf>

¹⁶ <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/PreventionOfJuvenileDelinquency.aspx>

¹⁷ <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/PreventionOfJuvenileDelinquency.aspx>

¹⁸ https://www.unicef.org/protection/RoL_Guidance_Note_UN_Approach_Justice_for_Children_FINAL.pdf

¹⁹ <http://www.un.org/en/ecosoc/docs/2005/resolution%202005-20.pdf>

²⁰ <https://www.coe.int/en/web/children/child-friendly-justice>

²¹ <http://www.ohchr.org/english/bodies/crc/docs/CRC.C.GC.10.pdf>

²² <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32016L0800>

